

## **E DREJTA PARLAMENTARE DHE POLITIKAT LIGJORE**

2000

### **Në këtë numër:**

#### **Opinione për Politikat Ligjore**

- Ndryshime në Kodin Penal
- Transferimi i pronave në njësitë e qeverisjes vendore

#### **E Drejta Parlamentare**

- Transparenca në veprimtarinë Parlamentare
- Komisionet Parlamentare
- Procedurat Amenduese

**1**

**Botimi i Qendres Studimore  
Mbi Praktikat Parlamentare  
Dhe Demokratike**

# PERMBAJTJA E REVISTES:

Numri I, viti 2000

	Faqe
Editorial	3
Përshëndetje nga :	
z. Lorn W. Craner	6
z. Pjetër Arbënor	8
z. Kastriot Islami	10
<hr/>	
Opinione mbi politikat ligjore:	
<hr/>	
❖ Për disa ndryshime në Kodin Penal:	
- Zamira ÇAKA, Kryetare e Komisionit Parlamentar të Ligjeve	12
- Spartak NGJELA, Anëtar i Komisionit Parlamentar të Ligjeve	16
❖ Mbi Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore:	
- Arben MALAJ, Kryetar i Grupit Parlamentar të PS	18
- Jemin GJANA, Kryetar i Grupit Parlamentar të PD	21
Informacion mbi legjislacionin e miratuar në Kuvend	28
<hr/>	
E Drejta Parlamentare	
Transparenca në veprimtarinë parlamentare, Sokol BERBERI	36
Vështrim krahasues mbi rolin e Komisioneve Parlamentare, Perikli ZAHARIA	44
Procedurat amenduese gjatë shqyrtimit në Kuvend, Filip LAKO	50
Informacion mbi veprimtaritë e organizmave ndërkombetare, Leon SHESTANI	56
Përmbledhje e përkthyer në anglisht	64





---

## EDITORIAL

# Përse botohet kjo revistë

I denë për botimin e një reviste mbi të drejtën parlamentare, themeluesit e QSPPD e kanë patur që në momentin e themelimit të kesaj organizate. Botimi i një reviste është vlerësuar si një instrument i natyrshëm dhe i domosdoshëm i një qendre studimore. Jo vetëm kaq, por, nevoja e krijimit të një mundësie për të shprehur ide dhe për të zhvilluar debate në këtë fushë është diskutuar shpeshherë gjatë kohës kur themeluesit e kësaj Qendre kanë shërbyer në Kuvend si këshilltarë. Sot, është një kënaqësi e vecantë për ne, që mundëm të botojmë Revistën mbi të Drejtën Parlamentare dhe Politikat Ligjore.

Përse botohet kjo Revistë dhe çfarë do t'i ofrojë lexuesit?

Paraqitja e politikave ligjore, në mënyrë të paanshme dhe objektive, do të zërë një vend të rëndësishëm në permbajtjen e Revistes. Debati Politik që pasqyrohet në median shqiptare sot midis forcave të ndryshme politike në vend shpeshherë personalizohet dhe si rrjedhojë publiku nuk është i qartë për qëndrimet e forcave të ndryshme politike për çështje të mëdha që prekin interesat e një kategorie të gjerë njerëzish. Publiku është njëkohësisht dhe

zgjedhësi, dhe, në këtë kontekst ai duhet të ndërgjegjësohet për qëndrimet dhe pikëpamjet e forcave të ndryshme politike.

Revista do t'i kushtojë një vëmendje të vecantë informacionit ligjor, duke patur parasysh se njohja fillestare e legjislacionit përbën një nga elementet vitale të një shoqërie demokratike. Lidhja midis qytetarëve dhe qeverisë së tyre është e fortë vetëm atëherë kur shqetësimet e tyre, pra, të publikut pasqyrohen në legjislacionin përkatës. Ky rol i publikut është i lidhur ngushtë me konceptin e legjitimitetit. Qytetarët që e konsiderojnë qeverinë e tyre si legjitime, ka më shumë të ngjarë që t'i binden edhe ligjeve të saj. Pjesëmarrja e publikut në procesin legjislativ është shumë e rëndësishme për një shoqëri demokratike. Në këtë kontekst, nevoja për gjetjen e mënyrave dhe rrugëve për të siguruar informacionin e nevojshëm për edukimin e publikut, si dhe përforcimin e njohurive për institucionet bëhet vitale.

Po kështu, nëse themi se koncepti i legjitimitetit të qeverisë nënkupton që qytetarët të kenë një njohje të caktuar për institucionet që i përfaqësojnë ata, na duhet të pohojmë se njohja nga ana e publikut rreth veprimtarive dhe praktikave parlamentare lë për të dëshiruar dhe pasqyrimi me transparencë i këtyre veprimtarive do të përbënte një hap më përpara drejt pjesëmarrjes së publikut, shoqërisë civile në procedurat parlamentare, një përpjekje më shumë drejt zhvillimit të demokracisë..

Dihet që vendi yne nuk ka pasur nje tradite të së Drejtës Parlamentare. Historia jone e afërt dhe e largët flet qartë për këtë. Revista synon të krijojë një dritare për një trajtim teoriko-shkencor të së Drejtës Parlamentare, e cila fillon nga burimi i institucionit ligjvënës, që janë zgjedhjet, e duke vazhduar me trajtimin e institucionit të Kuvendit, mënyrën se si organizohet, si funksionon, si merr vendime, si ushtron kontrollin ndaj ekzekutivit etj. Gjithashtu, edhe deputeti si një institucion individual do të trajtohet nga pikëpamja teorike në elemente të tilla si, statusi, imuniteti, papajtueshmëria etj.

Duke pasur parasysh procesin integrues të Shqipërisë në Evropë e më gjerë është e rëndësishme që publiku shqiptar dhe institucionet e interesuara të njohin dhe të ndjekin në vazhdimësi çështjet që diskutohen sot në nivel ndërkombëtar. Nëpërmjet Revistës, Qendra Studimore Mbi Praktikat Parlamentare dhe Demokratike, ndër të tjera, do të njohë publikun shqiptar me eksperiencat evropiane, të tilla si punimet e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Parlamentit Evropian, Unionit Ndërparlamentar, Asamblesë së NATO-s etj. Kjo do t'i shërbente përmirësimit të mëtejshëm të praktikave parlamentare, duke shtruar probleme, ide dhe alternativa në lidhje me këto çështje, si dhe informacion të specializuar për të ndikuar në rritjen e njohjes së publikut me ndryshimet që ndodhin në legjislacionin shqiptar, realitetet, problemet dhe arritjet në këtë fushë.

Qëllimi kryesor që synon të realizojë Qendra Studimore mbi Praktikat Parlamentare dhe Demokratike nëpërmjet kësaj Reviste, është dhënia e një kontributi sado modest për zhvillimin e demokracisë parlamentare, si dhe rritjen e efektivitetit në procesin legjislativ.

Me këtë rast, dëshirojmë të falenderojmë në mënyrë të veçantë “International Republican Institute” (IRI) dhe “National Endowment for Democracy” (NED) për mbështetjen financiare, me anën e së cilës u bë i mundur botimi i kësaj Reviste.

Sokol Berberi  
Drejtor Ekzekutiv  
Qendra Studimore mbi  
Praktikat Parlamentare  
dhe Demokratike

Letter of Introduction  
to The Review on  
Parliamentary Law  
and Politics

Letër prezantuese  
për Revistën mbi të  
Drejtën Parlamentare  
dhe Politikat Ligjore

*Dear Reader:*

I hope you will join me in welcoming the first edition of the Review on Parliamentary Law and Politics. The Review will fill a large gap in public information about the Assembly of Albania by publishing summaries of recently passed laws and providing balanced, in-depth coverage of political debates at the Assembly. We expect the Review to significantly expand the public's understanding of what goes on in Parliament, and by doing so, to strengthen Parliament as a central democratic institution of Albania.

The International Republican Institute (IRI) is pleased to provide technical and financial support for the Review on Parliamentary Law and Politics. IRI has worked closely with the Assembly of Albania since

*I dashur lexues,*

Shpresoj që edhe ju të bashkoheni me mua për t'i uruar mirëseardhjen numrit të parë të Revistës mbi të Drejtën Parlamentare dhe Politikat Ligjore. Revista do të plotësojë një boshllëk të madh në informimin e publikut për Kuvendin e Shqipërisë, duke publikuar përmbledhje të ligjeve të miratuara rishtazi, si dhe duke siguruar një pasqyrim të paanshem dhe të plotë të debatit politik në Kuvend. Ne presim që kjo Revistë të zgjerojë në mënyrë të dukshme vizionin e publikut mbi atë c'ka ndodh në Parlament, dhe duke vepruar kështu, në forcimin e Parlamentit si institucion qendror demokratik në Shqipëri.

Instituti Ndërkombëtar Republikan (IRI) ka kënaqësinë të ofrojë mbështetjen financiare dhe teknike

1994 to expand public access to the legislative process and to strengthen the Assembly as a representative institution of the Albanian people. The editors of the Review became known to IRI over the years of their service to the Assembly as parliamentary staff. They have since then cooperated with IRI on several successful projects and have gained IRI's confidence through their professional integrity and commitment to their work.

The Review on Parliamentary Law and Politics will, I am sure, offer useful information and analysis for all of you in Albania who take a professional or personal interest in the substantive work of Parliament. I welcome your comments on the Review and invite you to send your comments to IRI's office in Tirana.

Sincerely Yours,

Lorne W. Craner  
President  
International Republican Institute

për Revistën mbi të Drejtën Parlamentare dhe Politikat Ligjore. IRI ka punuar ngushtësisht me Parlamentin Shqiptar që në vitin 1994 për zgjerimin e aksesit të publikut në procesin legjislativ dhe për forcimin e Kuvendit, si institucionin përfaqësues i popullit shqiptar. Publikuesit e Revistës u bënë të njohur për IRI-n gjatë kohës kur ata shërbyen në Kuvend si staf i tij. Ata kanë bashkëpunuar me IRI-n në disa projekte të sukseshme dhe kanë fituar besimin e tij në saje të integritetit të tyre profesional dhe angazhimit në punë.

Jam i sigurtë që Revista mbi të Drejtën Parlamentare dhe Politikat Ligjore do të ofrojë një informacion dhe analizë të dobishme për të gjithë ju në Shqipëri, që keni një interes profesional apo personal për atë ç'ka është thelbësore në veprimtarinë e Parlamentit.


Juaji sinqerisht,

Lorne W. Craner  
President  
Instituti Ndërkombëtar Republikan



## Përshëndetje revistës

*Nga Pjetër Arbnori*



Pasuria e vetme që më ka lënë babai ka qenë një bibliotekë e madhe për kohën. Aty binin në sy koleksionet e shtypit të vjetër shqiptar, ndër të cilat disa edhe me alfabetet e hershme të Shkodrës, të Shoqërisë së të Shtypurit Shkronja Shqip të Stambollit, të Shoqërisë “Bashkimi” etj. Isha në shkollën fillore kur nisa të qëmtoj në këtë bibliotekë. Më ranë në sy disa revista me fletë të holla me titullin “Bisedimet e Këshillit Kombëtar, Bisedimet e Kuvendit

Kombëtar të viteve 1920 – 1924. Lexoja kuturu, por gjithë kureshtje. Shumë vonë më dhuruan koleksionin e plotë të bisedimeve të Parlamentit, fjalimet e deputetëve Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta, Mehdi Frashëri, Fan Noli, Ahmet Zogu, Hil Mosi, Lef Nosi, Avni Rustemi etj. të cilët spikasin në jetën politike të vendit. Kërkova në shtypin e kohës të dhëna të tjera për Parlamentin. Ndesha në një varfëri, që të mos themi, në boshllëk të plotë të informacioneve parlamentare. Kuptohet, derisa mungonte Parlamenti i Lirë, mungonin edhe shkrimet mbi Parlamentin dhe parlamentarizmin në Shqipëri.

Me arritjen e fitores së lirisë së partive nga lëvizja e dhjetorit 1990 dhe me zgjedhjet e para pluraliste, në mars 1991 u hap rruga që opozita të kishte vend në kuvend dhe fjala e lirë të thihej pa frike e pa u dënuar. Kur u diskutua rregullorja e Kuvendit, në prill të vitit 1991, më kujtohet që propozova të shtohet një nen i veçantë, që parashikonte botimin e një buletini të bisedimeve të Parlamentit, gjë që u pranua, por nuk u vu në jetë. Në

legjislaturat 1992-1996 dhe 1996-1997 bëjnë orvajtjet e para për të botuar një fletë të përdyjavshme, ku jepet rendi i ditës i bisedimeve të Parlamentit, mbledhjet e shkurtuara të komisioneve të Kuvendit, shënoshin me radhë takimet me delegacionet e huaja, përshkruheshin projekt-ligjet e shtruara për diskutim, emërimet dhe vendimet. Kjo ishte një fletore rudimentare, që shpresonim ta zhvillonim më tej. Fatkeqësisht, gjatë katër viteve të mëpastajme 1997-2000 Kuvendi e ndërpreu edhe këtë botim periodik.


Tani, me kënaqësi të posaçme shohim që Qendra Studimore Shqiptare Mbi Praktikën Parlamentare dhe Demokratike mori nismën për botimin e Revistës të së Drejtës Parlamentare dhe Politikave Ligjore. Atë që nuk e bën dot vetë Parlamenti sot, e merr përsipër një grup juristësh dhe specialistësh jashtë Parlamentit, që, me mendim profesional, synon të njohë publikun me legjislacionin shqiptar dhe ndryshimet e tij në kohë. Njëkohësisht, duke dhënë përvojën e institucioneve demokratike evropjane dhe botërore, pasurohet edhe praktika dhe veprimtaria jonë parlamentare dhe vihen në dukje edhe të metat tona që duhen plotësuar shkallë-shkallë.

Kjo revistë e specializuar do të dijë vetë dhe do të ndihmojë të tjerët të ndajnë egjren mbipolitike nga gruri i një debati konstruktiv, që mirëkupton këndvështrimet e ndryshme politike rreth projektligjeve të nevojshme për miratim, krahas informacionit dhe nxitjes së diskutimeve teorike dhe praktike, revista besoj se do të ndihmojë për të ndrequr të metën themelore që nuk kemi realizuar asnjëherë, sic është kontrolli parlamentar. Pa u rritur roli i komisioneve parlamentare dhe pa u krasitur komisionet ndihmëse të krijuara vetëm “për konsum”, parlamentarizmi nuk do të kthehet në një fenomen real në Shqipëri.

Pa njohur të Drejtën Parlamentare dhe pa ndihmuar për ta vënë në jetë atë, parlamentarizmi do të mbetet vetëm një e Drejtë për të folur, vetëm një shkallë më lart se heqja e nenit të agitacionit e propagandës. Mendoj se nga pikëpamja teorike, kjo Revistë në fillim modeste, do të ndihmojë, si gjithë shtypi i lire e serioz, për të vënë një tullë në ndërtesën e Demokracisë, e vështirë por jo e pamundur për t’u ngritur.

# Mbarësi botimit Suksese Qendrës

*Nga Kastriot Islami*



Është kënaqësi dhe nder njëkohësisht të përshëndesësh fillimin e botimit të një reviste të re shqiptare për të Drejtën Parlamentare, kësaj tribune ku mund të flitet në mënyrë racionale e shkencore, ashtu siç presupozohet të flitet nga përfaqësuesit e insitucionit më të rëndësishëm të një republike parlamentare, Kuvendit. Pra, përfaqësuesit e Kuvendit, politikanët, analistët do të kenë tashmë mundësi që nëpërmjet kësaj reviste dhe qendrës që e boton atë, të shprehin një dimension të ri të parlamentarizmit, ku do të amalgohen objektivizmi, profesionalizmi, aktiviteti shkencor e sistematik dhe zgjidhjet alternative përballë subjektivizimit, politizimeve dhe jo rrallë herë edhe diletantizmit e betejave personale të ndeshura edhe në tempullin më të lartë të një demokracie parlamentare.

E Drejta parlamentare është në radhë të parë e drejtë për informim, e drejtë për transparencë, e drejtë që e kërkon publiku ndaj institucionit të tij më të lartë të përfaqësimit. Vetëm kur kjo e drejtë arrin të ballancohet nga të dy anët, pra edhe nga zgjedhësit, dhe të zgjedhurit, vetëm atëhere marrëdhëniet publik-përfaqësues ekulibrohen dhe publiku e konsideron Kuvendin si institucionin e tij dhe nuk arrin asnjherë të vihet në konflikt me të, sepse korrigjimi permanent shmang gradientin që do të gjeneronte konfliktin.

Tani hapet një dritare e re për të gjithë palët, një dritare ku do të mund të debatohet në mënyrë profesionale dhe analitike. Kjo revistë do të japë mundësi të zhvillohet një dimension që deritani ka qënë rudimentar. Dimensioi teoriko-shkencor i trajtimit të elementëve të një demokracie parlamentare për probleme madhore, si zgjedhjet, sistemin gjyqësor, marrëdhëniet midis institucioneve apo mënyra e funksionimit të Kuvendit do të kenë impakt jo vetëm mbi vetë institucionet, por edhe në edukimin në një nivel të lartë të publikut. Kështu, publiku i gjërë do të ketë mundësi dhe do të aftësohet njëkohësisht të marrë pjesë në mënyrë aktive në procesin e hartimit dhe të miratimit të lëgjislacionit, duke patur mundësi të njihet me veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë dhe duke siguruar një informacion objektiv e transparent mbi legjislacionin shqiptar.

Qendra dhe revista kanë gjithashtu misionin të paraprijnë edhe integrimin europian të institucioneve shqiptare, në kuptimin që të sensibilizojnë dhe trajtojnë me deputetët, politikanët dhe analistët shqiptarë tematikat e përputhjes së legjislacionit shqiptar me Kushtetutën e Shqipërisë dhe në mënyrë të veçantë me atë europian.

Nuk ka asnjë dyshim se serioziteti i konceptimit të kësaj reviste presupozon vazhdueshmërinë e suksesit. Në mënyrë të thjeshtë do t'i uroja mbarësi si Qendrës Studimore mbi Praktikën Parlamentare dhe Demokracinë, ashtu edhe Revistës.

## Mbi disa ndryshime në Kodin Penal

*Zamira Çaka*

Kryetare e Kominisonit Parlamentar të Ligjeve

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, që ka hyrë ne fuqi më 1 qershor të vitit 1995, është ndërtuar sipas modeleve të kodeve penale të shteteve demokratike bazuar në parimet e dispozitave kryesore kushtetuese dhe në aktet juridike ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi.. Kodi Penal, i cili i përgjigjet standarteve ndërkombëtare, sanksionon parimin e ligjshmërisë në të drejtën penale, barazinë para ligjit, deklarinin e fajësisë.

Ne Kod shprehen qartë përpjekjet për dekriminalizimin e tij, ku janë hequr disa vepra penale me rrezikshmëri të vogël dhe është pasuruar me institute e figura të reja veprash penale, të diktuar nga praktika, konventa, akte juridike ndërkombëtare e nga e drejta penale ndërkombëtare. Nga ana tjetër, ai ka një koncept të ri në vendosjen e raporteve midis individit dhe shtetit, duke i dhënë përparësi mbrojtjes penale juridike të personit. Në këtë aspekt, Kodi Penal është një akt me rëndësi të madhe juridike, që shërben si armë efektive në luftën kundër kriminalitetit, mbrojtjen e të drejtave e lirive themelore të njeriut, rendit kushtetues e demokracisë, dhe realizimin e reformave ekonomike e shoqërore. Po sado i mirë që të jetë ligji penal, ai nuk është statik e i pandryshueshëm. Zbatimi i tij në praktikë dhe reformat legjislativë, sjellin domosdoshmërinë e ndryshimit e plotësisimit të tij në përputhje me dinamikën e jetës e veprimtarisë ekonomiko- shoqërore të demokracisë.

Shqipëria, si pjesëtare e familjes së madhe evropiane është e angazhuar të veprojë në përputhje me parimet demokratike evropiane për vendosjen e shtetit ligjor, nëpërmjet ngritjes së një kuadri institucional e legjislativ për funksionimin e sistemit ligjor, në përputhje me standartet evropiane. Miratimi i Kushtetutës së re, vendimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili shpall antikushtetues dënimin me vdekje, nënshkrimi i protokollit 6 të Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe kërkesat objektive të praktikës gjyqësore, diktuan nevojën dhe domosdoshmërinë e ndryshimeve e përmirësimeve në Kodin Penal.

Ndryshimet e propozuara, në gjashtë nene i përkasin pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, duke bërë një përcaktim të saktë të bazave dhe detyrave të legjislacionit penal, i cili bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës penale ndërkombëtare, si dhe në marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga shteti Shqiptar. Ai ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, mirëkuptimin me pakicat kombëtare dhe bashkëjetesën fetare.

Rritja e krimit të organizuar dhe trafiket, të cilat në të shumtën e rasteve bazën e tyre nuk e kanë në Shqipëri, por jashtë kufijve të saj, nën ndikimin direkt dhe aktiv të mafies dhe elementëve kriminalë të huaj, ka sjelle domosdoshmërinë e riformulimit e plotësimit të nenit 7 të Kodit Penal, i cili bën fjalë për zbatimin e ligjit penal, për veprat penale të kryera nga të huajt, duke rritur numrin e këtyre veprave dhe duke bërë një specifikim të qartë të tyre.

Me mjaft interes praqiten ndryshimet e plotësimet që i përkasin pjesës së posaçme të Kodit Penal, për vepra penale konkrete.

Në kuadrin e forcimit të luftës kundër krimit, veçanërisht atij të organizuar, korrupsionit e trafikëve, në një numër të madh dispozitash, si rrethanë e cilësuar janë shtuar, kryerja e veprës në bashkëpunim nga dy ose

më shumë persona me marrëveshje të mëparshme (si formë e krimit të organizuar), si dhe kryerja e krimit më shumë se një herë (përsëritësit). Këto ndryshime janë bërë për krime të rënda, të ndjeshme për shoqërinë dhe që kanë marrë përhapje, siç janë krimet seksuale, trafiket, etj., për të cilat është rritur edhe masa e dënimit.

Debate të shumta janë zhvilluar përsa i përket përsëritjes (kryerja e krimit më shumë se një herë) si rrethanë rënduese. Ka mendime se Kodi Penal i sotëm nuk e njeh përsëritjen si rrethanë rënduese, por dënimin veçmas për çdo rast dhe një shtesë e tillë në dispozita të veçanta, për krime të veçanta, do ta prishin linjën mbi bazën e së cilës është ndërtuar Kodi Penal. Mendimi dominues, të cilin edhe unë e përkrah, është se Kodi Penal nuk ka ndonjë linjë të përcaktuar që nuk mund të ndryshohet. Gjendja e kriminalitetit, dinamika e krimeve të rënda, sidomos ato që janë më shqetësuese, sjellin domosdoshmërinë e ndërtimit të një politike penale efikase, në luftën kundër krimit, prandaj dhe shtesa për vendosjen e përsëritjes si rrethanë rënduese do t'i shërbejë pikërisht këtij qëllimi.

Duke pasur parasysh faktin se nën 50 i Kodit Penal, i cili përcakton rrethanat rënduese në kryerjen e një veprë penale, nuk e parashikon përsëritjen si rrethanë rënduese, por në dispozita të veçanta ajo është parashikuar (me ndryshimet), u propozua që përsëritja, pra, kryerja e krimit më shumë se një herë të vendoset si rrethanë rënduese në nenin 50 të Kodit Penal.

Periudha e tranzicionit në Shqipëri shfaqti një fenomen të ri, atë të skemave piramidale huamarrëse, të cilat morën një përhapje të madhe dhe u bënë mjaft shqetësuese. Në këto kushte, në ndryshimet e Kodit Penal parashikohet të shtohen dispozita të reja për dënimin e skemave piramidale huamarrëse, gjë që pengon krijimin e tyre. Duke pasur parasysh pasojat që ato sjellin dhe rrethin e personave që prekin, si rrethanë cilësuese është parashikuar kryerja e veprës penale më shumë se një herë në bashkëpunim ose që ka sjellë pasojat të rënda. Me këtë plotësim do të mund të bëhet diferencimi i dënimeve.

Ndryshime e plotësime të rëndësishme janë bërë në dispozitat që parashikojnë veprat penale kundër lirisë së personit, duke bërë një formulim të plotë dhe të saktë të rrëmbimit të personit dhe duke shtuar si rrethanë cilësuese rastet kur personi torturohet, vdes, zhduket, etj.

Shpërdorimi i detyrës si një dispozitë e Kodit Penal, nga përvoja e deritanishme, ka qenë një dispozitë jo e plotë dhe jo e saktë dhe, si rrjedhojë, ka mbetur pa u zbatuar. Formulimi i ri synon të rrisë ndjenjën e përgjegjësisë të punonjësve të ngarkuar me funksion shtetëror ose shërbim publik në kryerjen e detyrës.

Në Kod janë parashikuar të shtohen edhe dispozita të reja të diktuar nga praktika jonë dhe ajo ndërkombëtare, siç janë ato për dënimin e personave që prodhojnë artikuj me patentë të tjetrit, për asgjësimin dhe vjedhjen e dokumenteve të arkivave dhe bibliotekave, për ndërhyrjet në transmetimet me rrjet kompjuterik, kur kanë sjellë pasoja të rënda, për zhdukjen ose humbjen e dosjeve hetimore, pastrimin e parave të pista etj.

Ndryshimet në Kodin Penal, në kuadrin e një pakete të plotë ligjore për reformën në gjyqësor, ku një pjesë e tyre janë miratuar dhe pjesa tjetër pritet të miratohet së shpejti në Kuvend, janë një mjet efektiv në luftën kundër kriminalitetit dhe synojnë mbrojtjen e lirive dhe të drejtave themelore të personit, forcimin e rendit e të qetësisë publike.



## Mbi disa ndryshime në Kodin Penal

*Spartak Ngjela*

Anëtar i Komisionit Parlamentar të Ligjeve

Ndryshimet e Kodit Penal mendoj se nuk duhen trajtuar si të nevojshme ose jo, por duhen parë në prizmin se çfarë sjellin në lidhje me zhvillimin e konceptit penal në Shqipëri, pra, në lidhje me raportin midis krimit dhe ndëshkimit. Në fund të fundit, një kod penal s'është gjë tjetër veçse paraqitja e sintetizuar e raportit krim-ndëshkim.

Ne ende nuk mund të themi se raportin midis krimit dhe ndëshkimit e kemi brenda asaj kërkese që quhet njëvlefshmëri, pra brenda mendimit se nëse personi që ka kryer krim ndëshkohet, është ndëshkuar brenda një marzhi social, domethënë brenda mendimit se ndëshkimi i tij ka lidhje të drejtpërdrejtë me nivelin e kriminalitetit shoqëror që rrjedh nga ky nivel.

Kështu, pra, në lidhje me sa thamë më lart, si aspekt i parë duhet pranuar se amendamentet e Kodit Penal, që të gjitha e rrisin shkallën e dënimit, gjë kjo që, natyrisht, ka lidhje të drejtpërdrejtë me nivelin e kriminalitetin në Shqipëri.

Prandaj mendoj se, ndonëse personalisht nuk prirem nga dënimet e rënda si teknikë penale, mendoj se në këtë situatë rritja e marzhit të dënimit për një seri krimesh, duhet ta justifikojë veten si përmirësim në praktikë, domethënë në uljen e kriminalitetit.

Aspekti tjetër që duhet pranuar si përmirësim i vizionit penal është fakti se në këto çaste sqarohet përfundimisht çështja e veprave penale të kryera më shumë se një herë.

Deri tani Kodit Penal i është quajtur si mangësi fakti i mungesës së këtij koncepti, i cili, pas amendamenteve, do ta sjellë Kodin Penal në nivelin konkret të konceptit “më shumë se një herë”, i cili tani del në Kod edhe si rrethanë rënduese, si nocion i përgjithshëm, por edhe si çast cilësimi, për ato dispozita ku është përmendur konkretisht.

Aspekt tjetër që duhet përmendur si përmirësim, që amendamentet i sjellin Kodit Penal, është edhe përmirësimi konceptual që i bëhet veprave penale që kanë të bëjnë me trafikun, prodhimin ose shitjen e narkotikëve. Deri tani, praktika ka qenë e pakonsoliduar, sepse dispozitat përkatëse në Kodin Penal ishin të turbulla, të papreçizuara, se kur mbaronte një vepër e kur fillonte tjetra, gjë kjo që tani mendoj se me amendamentet është përmirësuar deri në sqarim të plotë. Kam përshtypjen se mendimi që po jap, do të provohet nga zbatimi në praktikë i dispozitave të përmirësuara.

Për të gjitha këto, mendoj se amendamentet e Kodit Penal do të sjellin përmirësim të dukshëm në ecurinë praktike, ndonëse, sikundër dihet, shkalla e kriminalitetit është shumë e lartë. Megjithatë, çdo përmirësim në fakt është një hap përpara drejt përmirësimit të parametrave që përmban brenda tij raporti midis krimit dhe ndëshkimit. Sepse duhet pranuar se ne ende nuk kemi krijuar shkollën tonë për t’i dhënë përgjigje në çdo kohë nevojave që ka herëpashere përmirësimi i këtij raporti, qoftë me zbutjen e dënimeve, kur kriminaliteti është në rënie, qoftë me ashpërsim të dënimit, kur kriminaliteti është në rritje. Megjithatë, përmirësimi aktual, sikundër u tha, shpresoj se do të japë rezultate pozitive në praktikë.

# Mbi Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore

*Arben Malaj*

Kryetar i Grupit Parlamentar të PS

Decentralizimi i pushtetit vendor përbën për vendin tonë një reformë të plotë. Koncepti i decentralizimit tani është kthyer në detyrim kushtetues dhe njëkohësisht edhe detyrim që rrjedh nga Karta e Autonomisë Vendore, e ratifikuar në Kuvend. Por, si çdo proces, edhe ky kërkon kohën e nevojshme që të japë efektet që priten.

Hapat e domosdoshme në këtë rrugë mund të përmbliken në krijimin e legjislacionit të ri, në aderimin në organizmat ndërkombëtarë, në zbatimin në vendin tonë të standardeve europiane, në ngritjen e institucioneve që zbatojnë legjislacionin e ri, në rritjen e efektivitetit të strukturave vendore etj.

Vlerësoj se përparësore në procesin e decentralizimit kanë qenë konceptet e reja, jo thjesht për më shumë kompetenca, por për një bashkim më të drejtpërdrejtë të detyrimeve të pushtetit vendor për realizimin e funksioneve të tij dhe të shtimit të mundësive konkrete për realizimin e këtyre detyrimeve. Pikërisht në këtë këndvështrim është vlerësuar që, veç koncepteve të reja, veç kompetencave në rritje për pushtetin vendor, të jetë i domosdoshme edhe krijimi i elementeve pronësore ose mundësive përfituese nga e drejta e përdorimit të pronës publike që pushteti qendror i transferon pushtetit vendor. Paketa e re e decentralizimit fiskal, që po përgatitet për t'u miratuar në Kuvend, është një hap konkret në këtë drejtim.

Duke theksuar se kemi të bëjmë me dy momente: kalim në pronësi të

plotë të pushtetit vendor të disa pronave shtetërore dhe dhënie në përdorim të disa pronave të tjera. Dhënia në pronësi të pushtetit vendor të disa pronave shtetërore duhet kuptuar jo si një akt administrativ, por si një detyrim që lind nga procesi decentralizues.

Në ligjin e ri të funksionimit të pushtetit vendor është konkretizuar kalimi në administrim të pushtetit vendor të shumë prej funksioneve dhe shërbimeve publike që më parë ishin kompetencë e qeverisjes qendrore. Pushteti vendor nuk mund të administrojë drejt problemet e arsimit, të shëndetësisë, infrastrukturës, furnizimit me ujë etj., në qoftë se ai nuk do të ketë kompetenca reale dhe në qoftë se nuk do të ketë edhe hapësira më të plota edhe në problemet e pronësisë. Gjithashtu, ai nuk mund të bëhet përgjegjës për mbarëvajtjen e arsimit dhe të shëndetësisë në bashkinë ose komunën përkatëse, në qoftë se autoritetet vendore nuk kanë asnjë kompetencë për administratën, personelin e shërbimit, në qoftë se nuk kanë asnjë mundësi të investojnë në infrastrukturën e këtyre institucioneve.

Një efekt tjetër pozitiv do të jetë edhe thjeshtimi i ecurisë administrative, i procedurave vendimmarrëse dhe i shkurtimit të kohës së ndërhyrjes të këtyre institucioneve për të investuar ose përmirësuar gjendjen. Njëkohësisht me krijimin e pronave të pushtetit vendor, në funksionet dhe shërbimet publike të bashkësisë vendore, detyrimisht do të ndryshojë edhe mënyra e financimit të tyre, si edhe rruga e gjatë dhe e pakuptimtë e investimeve që identifikoheshin nga qendra, përfshiheshin në pushtet nga qendra dhe përzgjidheshin investitorët nga qendra.

Në ligj, veç konceptit të përgjithshëm të bashkimit të funksioneve publike në nivel vendor me prona vendore, gjen edhe konceptin për t'i krijuar pushtetit vendor më shumë hapësira për burime financiare aq shumë të domosdoshme.

Shumë elemente pronësie, që tashmë janë shtetërore, mund t'i kalojnë pushtetit vendor thjesht duke parë mundësinë e përdorimit të drejtpërdrejtë në nivel vendor. Po kështu, ligji parashikon të kalojë në favor të pushtetit vendor edhe prona që nuk lidhen drejtpërdrejt me funksionimin e njësive të

qeverisjes vendore, por rezultojnë të lira dhe këtu përfshihen troje, po edhe ndërtesa të paprivatizuara. Tani çdo bashki duhet të përgatisë strukturat, të cilat, së pari duhet të identifikojnë të gjitha këto mundësi dhe, së dyti, të ndërtohen variante optimale për shfrytëzimin sa më efektiv të tyre.

Përllogatitjet duhet të tregojnë se gjithnjë e më shumë njësitë të pushtetit vendor po u ofrohen burime potenciale, për të rritur të ardhurat e tyre vendore. Janë të ardhura që, sipas ligjeve në fuqi, mbeten për t'u investuar në këto njësi. Këto mundësi në rritje do të ndihmojnë konkretisht që të rriten investimet nga vetë njësitë e pushtetit vendor.

Aktualisht po punohet për të ndryshuar mendësinë në bashkësinë vendore, që të mos vazhdojë koncepti, se po u prish ujësjellësi i një komune, duhet të bëhet përgjegjëse ministria, se po u prish një copë rrugë, duhet të ndërhyjë Buxheti i Shtetit etj. Një element që është ndërtuar për të ndryshuar këtë mendësi është fakti që donatorët dhe Qeveria Shqiptare kanë rënë dakord që, për çdo projekt në njësitë e qeverisjes vendore, të ketë ndihmesë konkrete nga bashkësia vendore në fonde, pajisje ose punë konkrete. Kjo ndihmesë që është 5-10 për qind, është për të nxitur mirëmbajtjen e investimit, për të menduar për të ardhmen e investimit.

Mund të vazhdohet me shumë shembuj, por edhe njëherë dua të theksoj se kemi të bëjmë me një reformë dhe jo me akte të pjesshme, njëkohësisht është reformë, fillimisht për të ndryshuar mendësitë dhe pastaj për të ndjerë efekte konkrete.

Nuk duhet të lejojmë të deformohet thelbi i pronësisë ose i transferimit të së drejtës të pronësisë; këtu nuk bëhet fjalë për inventare, por për koncepte. Nuk po kalojmë thjesht një shkollë në pronësi të bashkisë ose komunës, por po shtojmë një mundësi, që të përmirësohet shërbimi arsimor për fëmijët e komunës. Duhet shumë angazhim që procesi i decentralizimit të vazhdojë, duhet të ndërtojmë legjislacion sa më të mirë, duhet të ndjekim nga afër ndërtimin e strukturave që parashikon ligji dhe, së fundi, të synojmë efektivitetin e gjithë këtij procesi.

# Mbi Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore

*Nga Jemin Gjana*

Kryetar i Grupit Parlamentar të PD-së

Ka disa muaj që në procedurat parlamentare po endet projektligji lidhur me “transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”. Është hera e dytë pas pesë vjetësh, që synohet t’i jepet pushtetit vendor në një mënyrë ose një tjetër tagri i gëzimit, posedimit ose përdorimit të një pjese të pronave të paluajtshme publike. Tentativa e parë është bërë në vitin 1995. Një projektligj i iniciuar atëherë për këtë qëllim nga Qeveria e asaj kohe, pas shumë debatesh në komisionet parlamentare, nuk u bë e mundur të kalohej në seancë plenare dhe të miratohej.

Tri ishin problemet themelore që penguan:

Së pari, lëmshi i ngatërruar i çështjeve të pronësisë dhe posedimi ende prej shtetit i një pjese të madhe pronash të shtetëzuara që dekada më parë ishin prona legjitime. Sapo kishte filluar procesi i njohjes dhe kthimit të pronave, si dhe kompensimi fizik i ish-pronarëve.

Së dyti, mungesa e regjistrimit, në mos përfundimtar, së paku të përafëruar, të pronësive. Atëhere ishte vetëm në hapat fillestare puna për krijimin e gjithë infrastrukturës dhe vënien në efikasitet të zyrave të regjistrimit të pasurive.

Së treti, vetë pushteti vendor ishte në mandatin e tij të parë, për rrjedhojë, në shumë aspekte nuk ishte i gatshëm për ta përballuar këtë transferim pronësie.

Pushteti vendor i dalë prej zgjedhjeve të korrikut të vitit 1992 ndryshonte thelbësisht me pushtetin e këshillave popullore që komandoheshin më parë se nga ligji, nga urdhrat, udhëzimet dhe vullneti politik i partisë-shtet. Por, gjithsesi, shumë faktorë objektivë dhe subjektivë e bënë atë ende të pamundur të shkonte me shpejtësi drejt standardeve të decentralizimit dhe autonomisë vendore.

Menjëherë pas ndryshimeve demokratike që sollën zgjedhjet e marsit të vitit '92, në pushtetit qendror, në fillim të qershorit të po atij viti, me ligjin nr.7570, u bënë disa ndryshime dhe shtesa në dispozitat kryesore kushtetuese, të cilat përcaktonin se organizimi dhe funksionimi i qeverisjes vendore bëhet mbi bazën e parimeve të vetëqeverisjes, pavarësisë dhe decentralizimit. Vetëm pak ditë pas miratimit të këtyre shtesave në Dispozitat Kushtetuese, Kuvendi Popullor miratoi ligjin nr. 7572, datë 10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal”, ku përcaktoheshin organet e qeverisjes vendore, kompetencat e tyre, nisma dhe vendimmarrja për çështjet përkatëse të juridiksionit të tyre, krijoheshin hapësira në fushën e ekonomisë dhe në menaxhimin e shërbimeve ndaj bashkësisë. Kështu, nisi procesi i decentralizimit dhe i kalimit të administrimit të shërbimeve publike nga organet qendrore tek ato vendore. Prej parimeve të decentralizimit dhe autonomisë janë bërë përpjekje të burojnë gjithë legjislacioni për pushtetin vendor në këto vite të tranzicionit social-ekonomik dhe politik të vendit. Procesi ka lëvizur në vazhdimësi, por fatkeqësisht jo në mënyrë lineare, jo me rezultatet që paramendoheshin, dhe pa arritur të dalë ende prej qarkut të mendësisë gati gjysmë shekullore të centralizimit dhe me mospërputhje të mëdha në mes asaj që thërritet “de jure” dhe ç’ka ekziston dhe lëviz “de facto”.

Gradualisht, u realizua kalimi i shërbimeve ndaj bashkësisë vendore nga pushteti qendror tek ai vendor. Pastrimi i qendrave të banuara, mirëmbajtja e rrugëve urbane e tash së fundi dhe e rrugëve rurale, shërbimet e varrimit, mirëmbajtja e trotuareve, kanalizimeve dhe gjelbërimit u pasua me kalimin dhe të shumë shërbimeve të tjera, si ato që kanë të bëjnë me ujësjellësat,

ndriçimin urban, institucionet kulturore e sportive etj.

Duhet pranuar se ky kalim gjoja gradual, fare mirë, para se të vlerësohet si ecuri drejt centralizimit, duhet përcaktuar si “lënie te dera” pushtetit vendor jo thjesht shërbimet, por dhe përgjegjësitë për nivelin sasior dhe cilësor të tyre. Dhe kjo, sipas meje, ka tri arsye themelore: Procesi i shtimit të shpejtë të popullsisë në zonat urbane, ndërtimet e paligjshme dhe vëllimi i madh i mbeturinave të ndërtimit, por dhe shtimi i konsumit të ushqimeve, si dhe shtimi i kërkesave për më shumë shërbime në llojshmëri, në sasi dhe cilësi, që kanë sjellë hendek të madh në mes të kërkesës dhe ofertës.

Kësaj i shtohen mungesa e përvojës dhe shumë mungesa të tjera që lidhen me aftësitë drejtuese e menaxhuese të autoriteteve vendore shqiptare të një moshe relativisht të re.

Së fundi, por më përpara nga rëndësia, lidhet me pamundësitë financiare për të përballuar shërbimet në rritje.

Qeveria qendrore u ka faturuar tashmë autoriteteve vendore shumicën dërrmuese të shërbimeve ndaj bashkësisë vendore, por kjo ka mbetur e pashoqëruar me faturën financiare.

Granti ose pjesa e buxhetit të kushtëzuar për autoritetet vendore është shumë larg madhësive optimale për të siguruar optimum shërbimesh. Veç kësaj, ende kuadri ligjor i lidhur me buxhetin, me sistemin fiskal dhe në tërësi me financat e shtetit nuk ka arritur të vendosë raportet e duhura dhe madhësitë e duhura të kontributeve të taksapaguesve vendorë, (kontribute që maten ende me një shifër në përqindjen e buxhetit vendor), të cilat do të ndikonin në rritjen dhe përmirësimin e nivelit të ulët të sigurimit të shërbimeve.

Asnjë tentativë drejt decentralizimit nuk mund të jetë efektive dhe frytdhënëse në rast se nuk shoqërohet me një decentralizim të mirfilltë financiar, me një decentralizim të buxhetit dhe të taksave vendore, me dhënien organeve të pushtetit vendor të mundësive ligjore, administrative dhe financiare në funksion të përmbushjes së misionit të tyre.



Parë nga ky këndvështrim, çmuj se transferimi i pronave publike tek autoritetet vendore është një mundësi më shumë, është pjesë e **trendit** për decentralizim të mirëfilltë financiar, është mundësi për më shumë shërbime, për më shumë investime në bashkësi.

Pas krizës së vitit 1997, kam mendimin se procesi i decentralizimit dhe i autonomisë vendore ka ngecur, është frenuar dhe rrudhur. Kjo mbase dhe si pasojë e kahjeve të kundërta politike dhe e konfliktualitetit mes dy niveleve të qeverisjes, të asaj qendrore socialiste dhe të asaj vendore demokratike.

Përveçse retushimeve, por dhe ato të mbetura në letër, asnjë ligj i ri nuk u bë në fushën e financave vendore, të buxhetit vendor, të tatimeve e taksave vendore. Përkundrazi, sasia e fondeve, që ka në dispozicion pushteti vendor ka pësuar zvogëlime të paimagjinueshme. Kështu, ndërsa në vitet 1995 dhe 1996, sasia e investimeve për qeverisjen vendore zinte përkatësisht 7.9 dhe 9.3 për qind të fondit të investimeve në shkallë vendi, në vitin 2000, fondi i investimeve për të gjithë administratat vendore është vetëm 0.6 për qind e gjithë fondit të investimeve në shkallë vendi. Për më tepër, në kundërshtim me ligjet e vendit dhe me Kartën Europiane të Pushtetit Vendor, investimet lihen në total dhe disponibël në duart e ekzekutivit qendror, që ai t'i përdorë si dhe ku të dojë.

Me ndryshimet e bëra më 1998 në “Ligjin për urbanistikën”, u bë një hap prapa në standardet ligjore të aplikuara, sepse një kompetencë e rëndësishme, siç është rregullimi dhe administrimi i territoreve vendore iu nënshtrua vullnetit qeveritar, pasi numri i të deleguarve të Qeverisë në këshillat e rregullimit të territorit kalon dukshëm numrin e përfaqësimit me të zgjedhurit vendorë. Pa asnjë motiv të qartë, mbeti i bllokuar ligji nr. 8224, datë 15.5.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunës”. Ndërkohë që numri i shërbimeve ndaj bashkësisë vendore ka ardhur duke u transferuar gjithnjë e më shumë te autoritetet vendore, numri i punonjësve të administratës vendore nuk ka ndjekur të njëjtit tregues, sepse, nëse më 1992 administrata vendore numëronte 6200

punonjës, në fund të vitit 1996 ky numër arriti në 8270, me synimin për të shkuar në 12000 në fund të vitit 2000, sipas dhe marrëveshjeve paraprake me Bankën Botërore. Në fund të vitit 1999 numri i tyre u reduktua në 7058 punonjës. Të gjitha këto janë pengesa edhe për zbatimin e ligjit të kalimit të një pjese të pronës publike te pushteti vendor. Kjo duhet të jetë në koherencë me zgjidhjen e shumë çështjeve të tjera të pafilluara ose të penguara, që përbëjnë së bashku tërësinë e sipërmarrjes së decentralizimit dhe autonomisë vendore.

Edhe duke e analizuar në vetvete, projektin e paraqitur e konsideroj se atij i mungojnë elementet kryesore, që do të konkretizonin transferimin e së drejtës së pronësisë ose të përdorimit. Vetë projektligji është emërtuar “Për transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, çfarë nënkupton se përcaktimi i pronave të qeverisjes vendore është kryer dhe tashmë mbetet vetëm saktësimi me ligj i procedurave të transferimit të pronave të paluajtshme shtetërore, nga pushteti qendror në njësitë e qeverisjes vendore, për krijimin e kushteve për ushtrimin e plotë të funksioneve të tyre vetëqeverisëse. Ndërsa përcaktimi i këtyre pronave mbetet tërësisht evaziv, sepse neni 2 saktëson se “ky ligj përcakton llojet e pronave, që do t’u transferohen njësitë të qeverisjes vendore”. Realisht qeverisja vendore bëhet pronare jo duke i përcaktuar llojet e pronave, por pronat konkrete, ndoshta pastaj vetëm për efekte listimi të ndara edhe në lloje. Ligji jo vetëm nuk merr përsipër të përcaktojë pronat në mënyrë eksplicite, por sipas nenit 25 të projektit, kompetencat i mbeten Këshillit të Ministrave vendimi për listën e pronave që do t’i transferojë çdo njësi të qeverisjes vendore.

Duke iu referuar nenit 4 të projektit, rezulton se shumica e llojeve të pronave që transferohen në njësitë e qeverisjes vendore, janë të tilla që vetëm sa shoqërojnë llojet e shërbimeve ndaj bashkësisë vendore, që u ngarkohen njësitë të qeverisjes vendore. Ato janë lloje pronash që përdoren për ushtrimin e funksioneve administrative, për realizimin e programeve arsimore, realizimin e funksioneve për shëndetin publik, në veprimtaritë

social-kulturore, me furnizimin me ujë të pijshëm, me sistemimin e ujërave të zeza, me sistemimin e trotuareve, shesheve publike, ndriçimit publik ose mirëmbajtjen e pronave të tilla si përmendoret, bustet me interes vendor etj. Të gjitha këto në të vërtetë vetëm rrisin ngarkesën financiare, pra nuk prodhojnë të ardhura, përkundrazi, shpenzojnë, rrisin barrën e shpenzimeve.

Mbeten, sipas nenit 4 të projektit, vetëm një numër relativisht i kufizuar pronash të tilla, si ato që përdoren për sistemin e transportit publik (nëse veprimtaria del me fitim), struktura dhe njësi rezidenciale me interes vendor, troje të lira, ndërtesa të paprivatizuara, pyje dhe parqe publike që kanë për qëllim të përdoren për interes vendor, të cilat mund të jenë burim të ardhurash. Por dhe transferimi i tyre mbetet krejtësisht evaziv, pasi neni 24 i projektit, kompetencën përfundimtare të përcaktimit ia jep Këshillit të Ministrave. Edhe në rastet kur prona është në “formën e aksioneve në një shoqëri tregtare dhe/ose ndërmarrje shtetërore” është përsëri pushteti qendror që ka në dorë të vendosë të transferojë “një pjesë ose tërë titujt e pronësisë së shtetit mbi kapitalin që ka në këto shoqëri”.

Duket që amullia, që ekziston në regjistrimin e pasurive dhe listimin e pronave, i ka lënë pezull dhe saktësimet në projekt, aq sa është e pamundur të thuash se çfarë konkretisht do të jetë përfitimi nga ky proces i kthimit në pronar të njërive të qeverisjes vendore.

Projekti i paraqitur nuk ka marrë përsipër të cekë edhe disa lloje pronash që lidhen me burimet e shfrytëzueshme natyrore, brenda territorit administrativ të çdo njësie të qeverisjes vendore. Të tilla, që nuk kanë përmasa për mbarë vendin, mund të jenë argjilat që përdoren për prodhimin e tullave, burimet e prodhimit të materialeve inerte, burimet termale, rezervate turistike ose gjuetie, të cilat, të miradministruara, do përbënin burime të rëndësishme për vetëfinancimin e veprimtarisë në njësitë e qeverisjes vendore. Po kështu, në kushtet dhe nivelet në të cilat gjenden strehimi i popullsisë, kthimin tek financimi shtetëror për ndërtimin e apartamenteve të banimit dhe kalimi i tyre pastaj në administrim të qeverisjes vendore do

të kryente njëherësh dy funksione: përmirësimin e shërbimit në parametrat e strehimit dhe burim të ardhurash për njësinë vendore, në funksion të shërbimeve ndaj bashkësisë vendore. Qindra objekte, zyra dhe hangare industriale figurojnë të zaptuara dhe të përshtatura për banim, qindra të tjera qëndrojnë si karakatina brenda qyteteve që mendoj se mund t'i përshtateshin qëllimit që parashtruar.

Këto mbeten disa prej objeksioneve, të cilat mund t'i shërbenin përmirësimeve të projektit të paraqitur. Ndërkohë ligji duhet të prezumojë çdo interferencë ose pengesë në zbatimin e parimit të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave të shtetëzuara gjatë dekadave të sistemit komunist.

Më së fundi, mbetet thelbësore pyetja për efektet që sjell ky projektligj në zhvillimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore.

Duhet pranuar se hapet një parantezë për efektet. Kur bëjmë fjalë për “efekte”, çështja shtrohet nëse me këtë transferim pronësie do të përmirësohet ose jo niveli i shërbimeve ndaj bashkësisë.

A do të ketë një produkt ky transferim pronësie, pra, a do t'i rrisë të ardhurat nga burime të brendshme të njësisë vendore? Me këtë kalim, rriten më shumë shpenzimet apo të ardhurat? Gjithsesi mbetet të pritët një bilanc, që askush sot nuk është në gjendje ta thotë dhe për më tepër ky projekt nuk të ndihmon dot për këtë përcaktim.

## Informacion mbi Legjislacionin e miratuar në Kuvend

**1. Ligji nr. 8660, datë 18.9.2000 “Për ratifikimin e Kontratës për blerjen e aksioneve të shoqërisë anonime AMC”.** Kjo Kontratë e ratifikuar nëpërmjet këtij ligji, është lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit dhe Konsorciumit Cosmote/Telenor, i klasifikuar i pari në tenderin për AMC, i cili ka si objekt të saj blerje aksionesh. Bazuar në ligjin nr.8515, datë 21.7.1999 “Për privatizimin e shoqërisë aksionere Albanian Mobile Communications (AMC) dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.121/2000 “Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.581, datë 8.12.1999 “Për kriteret e vlerësimit të ofertave për privatizimin e shoqërisë aksionere AMC Sh.A.”. Kontrata përcakton se Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit (shitësi) i shet Konsorciumit Cosmote/Telenor (blerësit) një numër prej 691,748 aksionesh të zakonshme të shoqërisë, që përfaqësojnë 85% të kapitalit të saj aksioner. Cmimi i pranuar për cdo aksion është 123.7445 dollarë amerikanë dhe shuma totale e blerjes së aksioneve është 85,600,000 dollarë amerikanë.

**2. Ligji nr. 8661, datë 18.09.2000 “Për Sigurimin Shoqëror Suplementar të Punonjësve të Policisë së Shtetit.** Ky ligj u garanton punonjësve të Policisë së Shtetit, që ndodhen në karrierë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 8553, datë 25.11.1999 “Për Policinë e Shtetit” dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre përfitime suplementare mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”. Punonjës policie që do të përfitojnë nga ky ligj janë: punonjësit

aktivë, në dispozicion, të pezulluar, me pagesë kalimtare, në pension, studentë, kursantë dhe ushtarë (ndihmësagjentë), me përjashtim të rasteve kur në këtë ligj përcaktohet ndryshe. Punonjësve të Policisë së Shtetit dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre u sigurohen përfitime suplementare mbi ato të përcaktuara në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, në 8 raste që janë përcaktuar në nenet 6 deri në 16. Përfitimet nga ky ligj nuk taten dhe rriten sa herë rriten pensionet e pleqërisë. Të ardhurat suplementare, të përcaktuara në këtë ligj, nuk i përfitojnë punonjësit që janë përjashtuar nga Policia e Shtetit për braktisje të detyrës ose që janë dënuar me burg nga gjykata me vendim të formës së prerë. Ligji ka 25 nene.

**3. Ligji nr. 8662, datë 18.09.2000 “Për trajtimin si titull ekzekutiv të faturës së konsumit të energjisë elektrike”.** Me këtë ligj bëhet titull ekzekutiv fatura tatimore e konsumit të energjisë elektrike, sipas modelit të caktuar nga Ministria e Financave, në zbatim të nenit 36 të ligjit nr 7928, datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar” .Ligji ka tri nene dhe shfuqizon ligjin nr. 8369, datë 09.07.1998 “Për trajtimin e faturave të konsumit të energjisë elektrike, në ngarkim të subjekteve shtetërore (buxhetore dhe jobuxhetore) dhe të subjekteve private si tituj ekzekutivë”.

**4. Ligji nr. 8663, datë 18.9.2000 “Për regjistrimin, klasifikimin, mënyrën e përdorimit dhe kontrollin e mjeteve lundruese me motor, me tonazh nën 20 NT”.** Ky ligj rregullon mënyrën e regjistrimit, të klasifikimit, të përdorimit dhe të kontrollit të mjeteve lundruese me motor, me tonazh neto të regjistrit nën njëzet ton (20NT) dhe ka për qëllim disiplinimin e përdorimit dhe sigurimin e kontrollit të këtyre mjeteve. Ligji ka për objekt mjetin lundrues me tonazh nën 20 NT, që ka fuqi të përgjithshme të motorit ose të motorëve më të lartë se 30 kilovatë/orë ose 40,8 kuaj/fuqi HP, të klasifikuar si të tillë nga Regjistri Detar Shqiptar ose

nga institucionet korresponduese të shteteve të tjera. Për këto mjete lundruese, ligji vendos detyrimin e përgjithshëm që ato duhet të jenë në cdo rast: a)-të matrikuara në kapiterinë e portit ose në zyrat që varen prej saj, përgjegjëse për territorin, dhe që ndodhen pranë liqeneve e lumenjve; b) dhe të regjistruara në zyrën e policisë kufitare, përgjegjëse për territorin. Kërkesa për regjistrim nga pronari ose nga bashkëpronarët e mjetit lundrues duhet t'i paraqitet zyrës së policisë kufitare, përgjegjëse për territorin, brenda pesë ditëve nga lëshimi i lejes së lundrimit. Ndër shkeljet e parashikuara nga ky ligj është rasti i zhvendosjes ose përdorimit të mjetit lundrues, pa marrë certifikatën e re të përdorimit ose/dhe rasti i regjistrimit të mjetit lundrues në favor të cilitdo që ka qenë i dënuar për një sërë veprash penale sipas përcaktimit në ligj. Këto shkelje përbëjnë kundravajtje penale dhe dënohen me gjobë nga 100.000 deri 150.000 lekë, si dhe me konfiskimin e mjetit lundrues.

**5. Ligji nr. 8664, datë 18.9.2000 “Për disa shtesa në ligjin nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalclirimtare të Popullit Shqiptar” ndryshuar me ligji nr.8526, datë 23.9.1999”.** Shtesa ligjore bëhet në nenin 3 te ligjit bazë, në të cilin përcaktohen dokumentet me anën e të cilave vërtetohet qenia veteran i Luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar. Me anën e ligjit 8664 njihet si dokument për vërtetimin e qenies veteran edhe dokumentat e lëshuara nga arkivat shtetërore të rretheve dhe të institucioneve shtetërore, në bazë të të dhënave të dosjeve personale që kane në ruajtje. Shtesa e dytë ligjore konsiston në parashikimin e rastit kur mungojnë dokumentat e kërkuara nga neni 3 i ligjit bazë, pjesëmarrja në Luftën Antifashiste Nacionalclirimtare dhe qenia veteran i saj mund të vërtetohet me vendimin e Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalclirimtare, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

**6. Ligji nr. 8665, datë 18.09.2000 “Për një shtesë në ligjin nr. 7748, datë 29.07.1993, për Statusin e ish të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist”.** Ky ligj ndryshon nenin 10 të ligjit nr. 7748, datë 29.07.1993, dhe me hyrjen në fuqi të tij do të rifillojë procesi i regjistrimeve për njohjen e së drejtës së statusit, proces i cili do të vazhdojë deri në datën 31.12.2000. Ligji ka dy nene.

**7. Ligji nr. 8666, datë 18.9.2000 “Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit nr.4, datë 7.9.2000 “Për disa ndryshime në ligjin nr.8554, datë 10.12.1999 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2000”.** Nëpërmjet këtij akti normativ, Qeveria synon: 1) Të sigurojë mobilizimin e plotë të të gjithë burimeve suplementare që po realizohen nga mbështetja buxhetore mbi nivelin në programin vjetor, nga të ardhurat që do të sigurohen nga privatizimi i pronës shtetërore dhe nga rritja e të ardhurave buxhetore jotatimore nga kompanitë publike; 2) Të reflektojë në ligjin për buxhetin e shtetit përdorimin e burimeve suplementare për financimin e shpenzimeve publike, duke garantuar plotësisht stabilitetin makroekonomik dhe parametrat kryesorë të përcaktuara në programet e përbashkëta me FMN-në dhe BB-re për përgatitjen e programit afatmesëm të buxhetit, MTEF/I dhe programit të reduktimit të varfërisë, PRGF/ja; 3) Të reflektojë në ligjin për buxhetin e shtetit rritjen e nivelit të shpenzimeve në përputhje me prioritetet e qeverisë dhe programin e buxhetit të miratuar nga Kuvendi; 4) Të mbështesë me fonde buxhetore projektet e nisura në kuadrin e krizës së Kosovës; 5) Të krijojë hapësira të reja për politika buxhetore sektoriale për vitin 2001, nga ulja e kostos së shërbimit të borxhit, nëpërmjet uljes së stokut të borxhit të brendshëm gjatë vitit 2000.

**8. Ligji nr. 8667, datë 23.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës “Për shmangien e tatimeve të dyfishta dhe parandalimin e evazionit fiskal për tatimet mbi të ardhurat” ndërmjet Qeverisë së Republikës të**



**Shqipërisë dhe Qeverisë së Maltës**". Konventa e ratifikuar zbatohet ndaj personave që janë rezidentë të njërit ose të të dy Shteteve Kontraktues. Jane objekt i Konventës tatimet mbi të ardhurat të zbatuara në emër të një shteti kontraktues ose nga autoritetet e tij lokale, pavarësisht nga mënyra e vjeljes së tyre. Tatimet ekzistuese ndaj të cilave do të zbatohet Konventa në Shqipëri jane: 1-tatimi mbi fitimet e personave juridikë; 2- tatimi mbi aktivitetin e biznesit të vogël; 3- tatim mbi të ardhurat personale.

**9. Ligji nr. 8668, datë 23.10.2000 "Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit"**. Ligji bën një rregullim më të plotë e me të drejtë për pajisjen e shtetasve me pasaportë për jashtë shtetit, në krahasim me ligjin ekzistues (Dekreti nr.7393, datë 12.06.1990 "Për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave", si dhe të disa ndryshimeve e shtesave që i janë bërë). Në ligjin e ri janë hequr disa kufizime për pajisjen me pasaportë për jashtë shtetit të ushtarakëve dhe të shtetasve që kanë detyrime për shërbimin ushtarak etj. Do të pajisen me pasaportë edhe fëmijët nën moshën 16 vjec, në zëvendësim të lejes së kalimit. Për këtë grupmoshë vlefshmëria e pasaportës është 5 vjet, kurse për grupmoshat mbi 16 vjec, pasaporta është e vlefshme për 10 vjet. Gjithashtu, është parashikuar që vlefshmëria e pasaportës mund të shtyhet vetëm një herë për një periudhë një-vjecare. Ligji përcakton dokumentet që duhen paraqitur për t'u pajisur me pasaportë si dhe rastet e pavlefshmërisë së saj, afatin kohor të plotësimit të pasaportës, sanksionet në rast humbjeje, etj. Pajisja me pasaportë të re do të bëhet pas përfundimit të afatit të vlefshmërisë së pasaportës ekzistuese. Ligji ka 16 nene dhe abrogon dekretin nr. 7393, datë 12.06.1990 "Për lëshimin e pasaportave dhe dhënien e vizave" (me ndryshimet e bra) si dhe cdo dispozitë që bie në kundërshtim me këtë ligj.

**10. Ligji nr. 8669, datë 26.10.2000 "Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave"**. Ky ligj synon, nëpërmjet regjistrimit, t'u ofrojë Kuvendit, qeverisë, njësisive të qeverisjes vendore, organizatave

ekonomike, shkencore dhe kulturore, si dhe të gjithë shoqërisë civile të dhëna të besueshme statistikore, të nevojshme për planifikimin dhe realizimin e politikave të përgjithshme të zhvillimit, për analizat private dhe publike të vendimmarrjes, për kërkime shkencore dhe, në përgjithësi, për përmirësimin e njohjes dhe të të kuptuarit nga shtetasit të realitetit demografik, ekonomik dhe shoqëror të vendit. Ligji rregullon organizmin dhe realizimin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë dhe të banesave në territorin e Republikës së Shqipërisë. Regjistrimi organizohet dhe zbatohet nga Instituti i Statistikave (INSTAT) nën mbikqyrjen e Komisionit Qendror të regjistrimit dhe me mbështetjen e komisioneve të regjistrimit në prefektura dhe të zyrave të regjistrimit në komuna e bashki. Momenti i regjistrimit, sipas ligjit, është mesnata e 31 marsit 2001. Mbledhja e të dhënave do të kryhet brenda muajit prill 2001. Regjistrimi mbulon të gjitha zonat, urbane dhe rurale. Ai përfshin popullsinë banuese, si dhe të gjitha objektet brenda territorit të Republikës, që përdoren për banim, pavarësisht nëse ato janë pronë e luajtshme ose e paluajtshme.

**11. Ligji nr. 8670, datë 26.10.2000 “Për gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.** Ky ligj përcakton kriteret dhe autoritetin për pranimin në Forcat e Armatosura, rendin e gradave, përparimin në gradë dhe në karrierë, përgjegjësitë që rrjedhin nga karakteri i vecantë i detyrës dhe i shërbimit ushtarak si dhe ndërprerjen e karrierës për ushtarakët e Forcave të Armatosura. Gradat ushtarake janë tituj dhe shenja dalluese në emërtesën e hierarkisë ushtarake. Hierarkia ushtarake përfshin rendin e gradave dhe të funksioneve. Rendi i gradave dhe i funksioneve në Forcat e Armatosura, sipas ligjit, shkallëzohet nga më e ulta në më të lartën, sipas lidhjeve e varësive që kanë ndërmjet tyre. Karriera ushtarake, në kuptimin e ligjit, është rendi i përgjegjësive të ushtarakut gjatë kohës që shërben në Forcat e Armatosura, sipas arsimimit, kualifikimit, aftësive drejtuese e profesionale dhe vjetërsisë së shërbimit. Ligji përcakton se, në hierarkinë ushtarake, ushtarakët janë oficerë,

nënoficerë dhe ushtarë (detarë). Ushtarakët e Forcave të Armatosura janë ushtarakë të shërbimit aktiv të përhershëm (të karrierës), të shërbimit aktiv të përkohshëm, të shërbimit aktiv të detyrueshëm, si dhe ushtarakë të rezervës.

**12. Ligji nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.** Ligji i lartpërmendur rregullon marrëdhëniet juridike të komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura dhe është bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në ligjet ekzistuese dhe në përvojën e vendeve të NATO-s dhe të partnerëve të saj. I domosdoshëm është ky ligj sidomos pas shkrirjes së Këshillit të Mbrojtjes si organ kolegjal vendim-marrës dhe krijimin e Këshillit të Sigurimit Kombëtar si organ këshillimor i Presidentit të Republikës. Në këtë ligj janë përcaktuar pushtetet dhe autoritetet e larta komanduese e drejtuese në Forcat e Armatosura, janë rikonceptuar detyrat dhe përgjegjësitë e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe të Këshillit të Sigurimit Kombëtar, si organ këshillimor pranë tij. Disa përgjegjësi që ishin të Këshillit të Mbrojtjes, me këtë ligj janë parashikuar t’i kalojnë Këshillit të Ministrave. Janë parashikuar, gjithashtu, detyrat e përgjegjësitë e Kryeministrit në fushën e mbrojtjes dhe të forcave të armatosura. Edhe për ministrin e Mbrojtjes ligji përcakton detyrat e përgjegjësitë në drejtimin e ministrisë dhe të Forcave të Armatosura, si autoriteti më i lartë i personelit ushtarak dhe civil në këto forca. Ai është përgjegjës para Kuvendit, Presidentit dhe Kryeministrit për zbatimin e politikës së mbrojtjes së vendit. Gjithashtu, në ligj janë parashikuar përgjegjësitë e Shtabit të Përgjithshëm, të shefit të Shtabit të Përgjithshëm, si dhe të komandantëve të llojeve të forcave. Sipas ligjit, detyra dhe përgjegjësi kanë edhe prefektët në rastet e gjendjes së luftës, gjendjes së jashtëzakonshme, të fatkeqësive natyrore, si dhe për problemet e rekrutimit. Ligji ka 44 nene dhe me miratimin e tij, shfuqizohet ligji nr. 8467, datë

31.03.1999 “Për kompetencat e Presidentit të Republikës si Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe i Këshillit të Sigurimit Kombëtar” dhe cdo dispozitë tjetër që bie në kundërshtim me të.

**13. Ligji nr. 8672, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e Konventës së Aarhusit për të drejtën e publikut për të pasur informacion, për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe për t’iu drejtuar gjykatës për ceshtjet e mjedisit”.** Kjo Konventë është miratuar në Aarhus të Danimarkës, në qershor të vitit 1998. Qëllimi i Konventës është të kontribuojë në mbrojtjen e së drejtës së cdo individi të brezave të sotëm e të ardhshëm, për të jetuar në një mjedis të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqënien e tij, duke vendosur detyrimin e cdo pale që të garantojë të drejtën e publikut për të patur informacion për mjedisin, për të marrë pjesë në marrjen e vendimeve mjedisore dhe për t’iu drejtuar gjykatës, në lidhje me ceshtje të mjedisit, në përputhje me klauzolat e kësaj Konvente. Cdo pale (duke përfshirë shtetin shqiptar), duhet të marrë masat e nevojshme legjislative, rregulluese dhe masa të tjera për të arritur një përputhje midis klauzolave që zbatojnë kushtet e së drejtës së informimit, pjesëmarrjes dhe së drejtës për t’ju drejtuar gjykatës në këtë Konventë, si dhe masat e duhura të zbatimit rigoroz, për të krijuar dhe ruajtur një kuadër të qartë, transparent dhe të qëndrueshëm për zbatimin e klauzolave të kësaj Konvente.

**14. Ligji nr. 8673, datë 26.10.2000 “Për ratifikimin e amendamentit të “Marrëveshjes së Kredisë”, nënshkruar në 7 mars 1994, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Borxhin e Jashtëm dhe Erste Bank Der Oesterreichischen Sparkassen AG (ish-Girocredit).** Objekti i këtij Amendamenti është shtyrja e disa shumave të borxheve që kanë lindur sipas Marrëveshjes së Kredisë të 7 marsit 1994, të përmendur më sipër. Ky Amendament përbën një pjesë të pandarë të Marrëveshjes së Kredisë së 7 marsit 1994 dhe nuk e përjashton atë, klauzolat e së cilës mbeten në fuqi të plotë pasi nuk preken nga ky Amendament.

# Transparenca në Veprimtarinë Parlamentare

*Sokol Berberi*

E DREJTA PARLAMENTARE



## HYRJE

Transparenca është një koncept fleksibël, që merr kuptime të ndryshme në kontekste të ndryshme. Për organet ligjvënëse ajo merr një rëndësi të veçantë. Transparenca siguron që përfaqësuesit e zgjedhur të jenë në kontakt me publikun dhe të përgjigjen përpara tij. Që zgjedhësit të bëjnë vlerësime dhe të zgjedhin nga veprimet politike të ndërmarra nga përfaqësuesit e tyre, parlamenti duhet t'i zhvillojë hapur punimet e tij. Në qoftë se publiku nuk mund të vëzhgojë se si përfaqësuesit e tyre e përdorin mandatin për të cilin ata janë zgjedhur, atëherë ushtrimi i zgjedhjes elektorale bëhet pa kuptim.

Më poshtë, paraqitet një tablo për transparencën në veprimtarinë parlamentare me një karakter informues dhe krahasues. Në fillim do të paraqiten garancitë kushtetuese për të drejtën e infomimit dhe transparencën, të cilat përbëjnë themelin juridik mbi të cilin duhet të institucionalizohet transparenca në procesin ligjvënës. Në vazhdim, transparenca parlamentare vlerësohet në pesë drejtime kryesore: zhvillimi i seancave të hapura, publikimi i procesverbaleve parlamentare, njohja me projektligjet, regjistrimi i votimeve dhe transparenca në komisione. Çdo njëri nga këto elemente është i rëndësishëm për të siguruar transparencën në parlament.

## GARANCITË KUSHTETUESE

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, në kreun për liritë dhe të drejtat vetjake, në nenin 23 deklarohet se “*E drejta e informimit është e garantuar. Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtrojnë funksione shtetërore. Kujdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.*” Këto të drejta dhe liri mund të kufizohen me ligj në rastet që përbëjnë “masa të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes të sigurimit kombëtar, të integritetit territorial, për mbrojtjen e sigurisë dhe të rendit publik, për parandalimin e krimeve, për mbrojtjen e shëndetit dhe të moralit, të reputacionit dhe të drejtave të tjerëve, për parandalimin e dhënies së informacionit të marrë në konfidencë, si dhe për të garantuar autoritetin dhe paanësinë e pushtetit gjyqësor”. Garantimi i respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut, të njohura në dispozitat kushtetuese, është detyrë e Gjykatës Kushtetuese. Çdo person ka të drejtë të bëjë kërkesë për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, lidhur me shkeljen e lirive dhe të drejtave të tij të parashikuara nga Kushtetuta. E drejta e informimit, deri më sot, nuk është bërë objekt shqyrtimi dhe vendimi në këtë Gjykatë. Në kreun “Për Liritë dhe të Drejtat Politike”, një e drejtë tjetër e rëndësishme lidhur ngushtë me të drejtën e informimit është deklarimi se “Kushdo, vetë ose së bashku me të tjerë mund t’u drejtojë kërkesa, ankesa ose vërejtje organeve publike, të cilat janë të detyruara të përgjigjen në afatet dhe kushtet e caktuara me ligj”. Në kushtetutat e disa vendeve u është dhënë një rëndësi më e veçantë së drejtës për informim dhe transparencës. Kështu, në Kushtetutën Suedeze përcaktohet në mënyrë të qartë detyrimi i organeve shtetërore për t’i krijuar mundësi publikut për t’u njohur me dokumentet zyrtare, me procedurën për realizimin e kësaj të drejte, si dhe rastet e veçanta kur ajo mund të kufizohet. Një detyrim i tillë për organet shtetërore parashikohet edhe në Kushtetutën Holandeze.

Parimi i zhvillimit të mbledhjeve të hapura të Kuvendit është i njohur nga Kushtetuta, në nenin 79. Në raste të veçanta Kuvendi mund të vendosë që një mbledhje të zhvillohet me dyer të mbyllura kur kërkohet nga Presidenti i Republikës, Kryeministri ose një e pesta e deputetëve, dhe për këtë vendosin shumica e të gjithë deputetëve. Rregullim më të hollësishëm ky parim gjen në Rregulloren e Kuvendit.

Detyrimi për botimin e ligjeve në Fletoren Zyrtare përcaktohet në nenin 84 të Kushtetutës. Për aktet e ekzekutivit (të Këshillit të Ministrave dhe të ministrave), detyrimi për botim në Fletoren Zyrtare është vetëm për ato me karakter normativ.

Një element të ri që ka sjellë Kushtetuta në këtë drejtim është dhe detyrimi për botimin e marrëveshjeve ndërkombëtare që ratifikohen me ligj.

## ZHVILLIMI I SEANCAVE TE HAPURA PLENARE

Seancat plenare të Kuvendit zhvillohen të hapura, me përjashtim të rasteve kur Kuvendi vendos ndryshe, sipas parashikimit në Kushtetutë. Rregullorja e Kuvendit përcakton se për shqyrtimin e buxhetit ose për projektligje financiare nuk mund të kërkohet bërja e seancës me dyer të mbyllura. Në përgjithësi, në rregulloret e parlamenteve në Europë përcaktohen rastet kur mund të zhvillohet një seancë me dyer të mbyllura dhe ato janë të kufizuara, siç mund të ishte p.sh., rasti i sigurimit kombëtar. Ka dhe rregullore, siç është ajo e Çekisë, që përcakton dhe rastet kur nuk mund të bëhet seancë me dyer të mbyllura, siç janë ato gjatë shqyrtimit të buxhetit ose ligjeve të tjera financiare. Kur vendoset që seanca të zhvillohet me dyer të mbyllura, procesverbalet, diskutimet dhe regjistrimet radiotelevizive të këtyre mbledhjeve administrohen sipas rregullave të sekretit shtetëror. Vendimet që merren, shpallen publikisht. Në praktikën parlamentare, nga viti 1991 dhe në vazhdim, kemi vetëm dy raste të zhvillimit të seancave me dyer të mbyllura, gjatë legjislaturës së 15-të.

Persona nga publiku mund të marrin pjesë në seancat e Kuvendit. Këta persona më parë pajisen me një fletë-hyrje dhe duhet të qëndrojnë në galeri, vend i përcaktuar për publikun. Kapaciteti i galerisë është për 240 persona. 66 vende janë të rezervuara në llozha për personalitetet e larta shtetërore dhe për trupin diplomatik. Në praktikë, persona të ndryshëm nga publiku i marrin ftesat nëpërmjet deputetëve ose grupeve parlamentare. Mendoj se një procedurë më e thjeshtë duhet të vendoset për t'i krijuar mundësinë çdo personi, për të realizuar dëshirën e tij për të asistuar në seancat plenare të Kuvendit. Një model do të ishte ai i Budestagut në Gjermani. Personat nga publiku, që dëshirojnë të asistojnë në mbledhjet e Budestagut, paraqiten më parë në zyrën e vizitorëve, e cila bën programimin ose i regjistron ata për vendet që janë të disponueshme në çastin e mbërritjes.

Për përfaqësuesit e medias, shtetërore ose të pavarur, nuk ka ndonjë pengesë për të ndjekur mbledhjet e Kuvendit. Krijohet një listë me emrat e gazetarëve që kanë të drejtë të hyjnë në galeri në godinën e Kuvendit mbi bazën e kërkesave të bëra në mënyrë paraprake. Në galeri nuk ka vende të veçanta për përfaqësuesit e medias, të ndara nga ato të publikut, ndërsa për gazetarët e RTSH-së dhe për aparaturat teknike janë caktuar dy llozha.

Transmetimi i mbledhjeve të Kuvendit nga RTSH-ja është parashikuar në Rregullore. Seancat e pyetjeve, të interpelancave dhe mocioneve, për vetë rëndësinë që paraqesin, jepen të plota në RTSH. Për raste të tjera, Byroja e Kuvendit vendos me konsensus, duke u këshilluar dhe me Kryetarin e Komisionit të Përhershëm të Mjeteve të Informacionit Publik dhe kryetarët e grupeve parlamentare. Konsensusi i kërkuar për rastet e tjera, mendoj se është një kusht garantues për mospërdorimin në Kuvend të transmetimit në RTSH për qëllimet e saj politike nga mazhoranca.

Këshilli Drejtues i RTSH-së ka nxjerrë një vendim të rëndësishëm, “Mbi kriteret e transmetimit në Radio dhe Televizion të punimeve të Kuvendit Popullor”. Në këtë vendim përcaktohet se në edicionet informative në Radio e Televizion duhet të jepen rregullisht lajme të shkurtra për rendin e ditës të seancës, si dhe për debatet dhe vendimet përkatëse, duke dhënë



brenda të njëjtës temë opinione alternative. Vendosja e një rubrike të posaçme “Sot në Kuvendin”, jashtë edicionit të lajmeve, parashikohet në pikën 2 të këtij vendimi. Në këtë rubrikë do të jepet në kohëzgjatje të barabartë një kronikë e hollësishme për punimet e ditës, opinione sinkron të përfaqësuesve të grupeve parlamentare, të partive të pozitës dhe të opozitës. Kjo rubrikë ende nuk është vënë në jetë.

## PUBLIKIMI I PROCESVERBALEVE DHE AKTEVE PARLAMENTARE

Debati në seancë plenare regjistrohet në magnetofon dhe më pas zbardhet nga redaktorët e Kuvendit. Në Rregulloren e Kuvendit parashikohet mbajta e procesverbaleve stenografike gjatë seancave plenare (neni 38). Deri në fund të vitit 1993, shërbimi stenografik ka qënë i pranishëm në seancë. Ky shërbim u rivendos përsëri në shkurt 1998. Aktualisht, nga redaktorët është mbaruar zbardhja e debateve parlamentare të viteve 1991, 1992, 1993, 1994 dhe 1998 dhe është duke u zhvilluar procesi i zbardhjes së debateve parlamentare për vitet e tjera. Procesverbalet e seancave parlamentare depozitohen në arkivin e Kuvendit. Në Rregulloren e Kuvendit parashikohet që këto bisedime duhet të publikohen, por deri më sot nuk është arritur që këto procesverbale të publikohen. Persona nga publiku dhe media mund të njihen me këto procesverbale (neni 38). Kopje të këtyre procesverbaleve nuk mund të gjenden as në Bibliotekën e Kuvendit, ndërkohë që në këtë bibliotekë gjenden bisedimet parlamentare para vitit 1944, duke filluar me Kongresin e Lushnjës të vitit 1920. Mendoj se kjo bibliotekë duhet t'i disponojë të gjitha këto procesverbale, si dhe të shihet mundësia e hapjes së saj për publikun. Ndërkohë, është duke u shqyrtuar mundësia e botimit të debateve parlamentare për vitet 1991-1993 dhe po bashkëpunohet me disa fondacione për të mbështetur botimin e këtyre debateve për vitet në vazhdim.

Botimi i debateve parlamentare të viteve 1920-1939 është një traditë dhe përvojë shumë pozitive tek e cila duhet të mbështetemi. Të kundërtën

mund të themi për periudhën e sistemit monist. Siç dihet, para vitit 1991 ose më saktë para vendosjes së pluralizmit, Kuvendi mblidhej dy herë në vit dhe punimet vazhdonin 1-2 ditë. Edhe atëherë ato çka thuheshin në Kuvendin Popullor (se për debate as që mund të bëhej fjalë) regjistroheshin dhe mandej zbardheshin dhe mbeteshin pronë vetëm e Kuvendit ose e Arkivit të Shtetit. Pra, as që mund të bëhet fjalë, jo vetëm për publikim, por as edhe për t'iu vënë në dispozicion medias së asaj kohe.

Procesverbalet e seancave plenare publikohen brenda një dite nga dita e seancës, pothuajse në të gjitha vendet perëndimore. Në Gjermani nuk botohen në mënyrë zyrtare deri në fund të vitit, megjithatë procesverbale jozyrtare janë të disponueshme për median brenda ditës. Në Kanada, Francë, Suedi, Mbretërinë e Bashkuar dhe Shtetet e Bashkuara, procesverbalet stenografike publikohen një ditë pas seancës plenare, ndërsa në Finlandë, Hollandë dhe Norvegji ato botohen pas më pak se një javë. Në Austri botimi mund të zgjatet në disa javë, por procesverbale stenografike jozyrtare janë të disponueshme për median pas një dite. Në shumicën e vendeve perëndimore mundësi e barabartë njohjeje parashikohet për publikun e gjerë dhe median. Në Europën Qendrore dhe Lindore, procesverbalet stenografike publikohen zyrtarisht në shtete si Bullgaria, Çekia, Hungaria, Lituania, Polonia, Rumania dhe Sllovakia. Këto procesverbale botohen një ditë pas seancës në Poloni dhe brenda disa ditëve në Hungari. Media dhe persona nga publiku kanë mundësi të njihen me procesverbalet stenografike disa orë pas seancës në të gjitha këto vende. Mendoj se përvoja e mirë e vendeve Europiane, por edhe e jona e kohës së paraçlirimit, duhet të shfrytëzohet për rifillimin e botimeve të bisedimeve parlamentare.

Në Rregulloren e Kuvendit parashikohet nxjerrja e një Buletini të Kuvendit. Ky Buletin filloi të nxirrej nga janari 1998. Në këtë Buletin paraqitej një informacion për programin e punimeve të Kuvendit dhe kalendarin javor, për seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve, si dhe për veprimtari të tjera parlamentare. Ky Buletin i vihej në dispozicion edhe

medias. Fatkeqësisht, nxjerrja e këtij Buletini ka disa muaj që është ndërprerë.

## NJOHJA ME PROJEKTLIGJET

Projektligjet që depozitohen në Kuvend, Kryetari i bëhen të njohura dhe ua shpërndan deputetëve sipas komisioneve parlamentare përkatëse. Kopje të projektligjeve u vihen në dispozicion edhe përfaqësuesve të medias, si dhe personave të tjerë të interesuar, me kërkesën e tyre. Ky shërbim kryhet nëpërmjet zyrës së shtypit. Krijimi i mundësisë për median e publikun për t'u njohur në mënyrë paraprake me projektligjet, përbën një kusht të domosdoshëm dhe të rëndësishëm për pjesëmarrjen e tyre në mënyrë aktive dhe efektive në procesin e shqyrtimit e miratimit të projektligjeve në Kuvend.

## REGJISTRIMI I VOTIMEVE

Në Rregulloren e Kuvendit parashikohen dy tipe votimesh: 1-votim i hapur; 2-votim i fshehtë. Për çështjet që kanë të bëjnë me ligjet financiare, me bilancin, si dhe me vendime të tjera që sjellin pasoja financiare nuk mund të bëhet votim i fshehtë. Në praktikë, votimi i fshehtë, në të shumtën e rasteve, bëhet sipas mënyrës tradicionale, me hedhjen e fletëve të votimit në një kuti të caktuar. Por ka pasur dhe raste që është përdorur sistemi elektronik, i cili garanton, gjithashtu, fshehtësinë e votimit. Rezultatet e votimit shpallen në seancë, ndërsa fletët e votimit depozitohen në arkivin e Kuvendit. Votimi i hapur bëhet: a) me ngritjen e dorës; b) me thirrjen e emrit (nominal) dhe c) me mjete elektronike. Me instalimin e pajisjeve elektronike, zakonisht votimi në parim dhe në tërësi bëhet me mjete elektronike, ndërsa votimi nën për nën me ngritjen e dorës. Në rastin e votimit me mjete elektronike, lista e votuesve printohet dhe depozitohet në arkiv. Në praktikë, kjo listë nuk i shpërndahet medias, por në rast se më pas një gazetar do që të njihet me të, ai e ka këtë mundësi. Votimi nominal bëhet me apel të deputetëve. Deputetët thirren sipas listës dhe ata përgjigjen

“pro”, “kundër” ose “abstenim”. Lista e deputetëve me shënimin e votës “pro”, “kundër” ose “abstenim” të secilit deputet duhet të publikohet së bashku me materialet e mbledhjes, por në fakt, siç e përmendëm më sipër, kjo gjë nuk ka ndodhur.

## TRANSPARENCA E KOMISIONEVE PARLAMENTARE

Në Rregulloren e Kuvendit përcaktohet se mbledhjet e komisioneve janë të hapura, me përjashtim kur komisioni vendos që ajo të bëhet e mbyllur. Gjithashtu, parashikohet që “përfaqësuesit e shtypit dhe të radiotelevizionit mund të asistojnë në mbledhjet e komisionit” (neni 67). Organizimi i seancave publike me përfaqësues të organizatave qeveritare, si dhe me subjekte të tjera të interesuara, përbën një synim të rëndësishëm, i cili është institucionalizuar në Rregullore. Mendoj se kontakti i komisioneve me këto organizata duhet të rritet në të ardhmen dhe të vendoset mbi një bazë bashkëpunimi dhe shkëmbimi të informacionit në mënyrë të vazhdueshme.


Radiotelevizioni, në praktikë, në përgjithësi është i pranishëm në mbledhjet e komisioneve dhe transmeton në edicionet e lajmeve kronika të shkurtëra mbi këto mbledhje. Në vendimin e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit, lidhur me transmetimin e veprimtarive të Kuvendit në televizion, përcaktohet se një përmbledhje për diskutimet në këto komisione do të jepen në rubrikën “Sot në Kuvend”, por, siç u përmend dhe më lart, kjo rubrikë ende nuk është realizuar.

Ky ishte një parashtrim i shkurter i problemeve që kanë të bëjnë me transparencën në procesin ligjvënës, pa pretenduar se janë trajtuar të gjitha çështjet në mënyrë të plotë. Transparenca përbën një parim shumë të rëndësishëm dhe pasqyrohet nëpërmjet një procesi, i cili vjen duke u zhvilluar në kuadrin e gjithë proceseve demokratike në vendin tonë.

# Vështrim krahasues mbi rolin e komisioneve parlamentare

*Perikli Zaharia*

E DREJTA PARLAMENTARE



## ORGANIZIMI I KOMISIONEVE

Çdo legjislativ demokratik krijon komisionet e përhershme për të përmbushur funksionet e veta dhe për të qenë në efikasitet. Rritja e kësaj të fundit është e lidhur ngushtë me impenjimin dhe punën e mirëfilltë të këtyre komisioneve.

Numri i komisioneve të përhershme është i ndryshëm në legjislativin e vendeve të ndryshme. Në disa vende numri i komisioneve të përhershme është i parashikuar në Kushtetutë, p.sh. në Francë (gjashtë për secilën dhomë). Në Shqipëri numri i komisioneve dhe fusha e veprimit të tyre caktohen nga Kuvendi në fillim të çdo legjislature. Kuvendi ynë ka trembëdhjetë komisione të përhershme, që mbulojnë fusha të ndryshme të veprimtarisë jetësore. Do të ishte e dobishme që ndryshimi i numrit të komisioneve të përhershme të bëhej duke ndjekur përvojën e disa vendeve demokratike, me konsensusin e grupeve parlamentare.

Në SHBA, secila dhomë e Kongresit ruan një numër komisionesh të quajtura “standing committees”, të konsideruara të përhershme dhe të krijuara në pajtim me fusha të ndryshme të jetës: si bujqësia, shërbimi i forcave të armatosura, çështjet e jashtme, arësimi, puna etj. Komisionet e Asamblesë Nacionale të Francës janë në disa drejtime të ngjashëm me ato

të legjislativit amerikan. Ndryshimi kryesor në Francë është Instituti i Reporterit “Rapporteur”. Dhoma Britanike e Komuneve, në ndryshim nga legjislativi amerikan dhe francez, ruan tetë komisione të përherëshme “standing committees”, të emëruara sipas alfabetit: Komisioni A, B, C e kështu me radhë. Komisionet britanike dhe franceze janë të specializuara sipas çështjeve të ndryshme dhe janë më pak të fuqishëm se korresponduesit e tyre në shumë parlamente të tjera.

Gjatë Republikës së Tretë dhe të Katërt të Francës, fuqia e komisioneve franceze ishte e njëjtë me ato amerikane, megjithatë, Kushtetuta e Republikës së Pestë (1958) e pakësoi këtë fuqi. Numri i komisioneve të përgjithshme të përherëshme u pakësua nga nëntëmbëdhjetë komisione të specializuara, në gjashtë të paspecializuara. Pothuajse në të gjitha vendet demokratike përfaqësimi në komisionet e përherëshme është në përpjesëtim me numrin e vendeve që zënë forcat politike në legjislativ.

Rregulli i vendosur nga Kuvendi se një deputet mund të bëjë pjesë në të njëjtën kohë në dy komisione të përherëshme, për efekt përfaqësimi të grupeve më të vogla në numër (neni 22 i Rregullores së Kuvendit), është një zhvillim pozitiv i demokracisë parlamentare, për të mbuluar çështjet politike që lidhen me programin e partisë së tyre dhe sigurohet përfaqësimi i përshtatshëm në një spektër politik më të gjërë në veprimtarinë e ndryshme të Kuvendit.

Legjislativët demokratikë, përveç komisioneve (komiteteve) të përherëshme “standing committees”, krijojnë herë pas herë komisione të zgjedhura “select committees”, të cilët marrin në pyetje, bëjnë hetime të veçanta dhe rekomandime për çështje të caktuara. Në Itali, p.sh, secila dhomë krijon komisione hetimi për çështje të interesit publik.

Legjislativët bikameralë (me dy dhoma) krijojnë nganjëherë komisione të bashkuara “Joint committees”, të përbërë prej anëtarëve të secilës dhomë, për të mbikqyrur çështje të caktuara. Kështu, hetimet në skandalet e Kongresit Amerikan, si ato të komisionit (komitetit) të përbashkët të Senatit të Dhomës së Përfaqësuesve në vitin 1988, për përpjekjet e fshehta të

këshilltarit të Sigurimit Kombëtar, John Poindexter-it dhe ndihmësit të tij Oliver North-it për t'i shitur armë Iranit dhe për t'i përdorur paratë e fituara për të financuar ndihmën ndaj “contrasve” nikaraguanë, është një shembull i njohur i kohëve të fundit. Po kështu, në fund të viteve '70, të dy dhomat e Kongresit Amerikan u krijuan komisione (komitete) për të hetuar vrasjet e Presidentit John F.Kennedy në vitin 1963 dhe Martin Luther King Jr. në vitin 1968, për të mësuar nëse ato ishin akte të vrasësve individualë, siç kishin konkluduar hetimet e herëshme, apo ishin rezultat i konspiracionit.

Edhe Dhoma e Komunëve në Britaninë e Madhe ka themeluar shumë komisione (komitete) të caktuara për hetime të posaçme, të quajtura “Select Committees”. Këto komisione kanë për qëllim të gërmojnë dhe të mbledhin informacionin e dëshiruar nga kjo Dhomë. Për këtë shkak, ato mbajnë seanca dëgjimi, “hearings”, urdhërojnë paraqitjen para tyre të personave (dëshmitarëve) dhe dokumenteve dhe më pas paraqesin raport, i cili shpeshherë stimulon ndryshimet në legjislacionin ekzistues dhe praktikat administrative. Megjithatë, britanikët, ndryshe nga amerikanët, kryejnë shumë prej hetimeve qeveritare nëpërmjet komisioneve mbretërore.

Komisione *ad hock* janë krijuar edhe nga Kuvendi, si për shembull për ngjarjet e Shkodrës të 2 prillit 1991, për të verifikuar rezultatet e hetimit, të kryera nga organet e ndjekjes penale, si dhe për ngjarjet e marsit 1997. Në përbërjen e këtyre komisioneve nuk janë vetëm deputetë, por edhe persona të tjerë specialistë. Por, si rregull, ndryshe nga komisionet amerikane ose britanike të hetimit, ato nuk mbajnë seanca dëgjimi (hearings) dhe nuk urdhërojnë paraqitjen para tyre të personave të ndryshëm si dëshmitarë.

## SHQYRTIMI I PROJEKTLIGJEVE NGA KOMISIONI

Në pjesën më të madhe të parlamenteve demokratike, projektligjet u dërgohen dhe shqyrtohen nga komisionet përpara se ato të kalojnë për shqyrtim dhe debat të përgjithshëm në seancë plenare (në tërë dhomën). Për rrjedhojë, komisionet kanë shumë për të thënë jo vetëm rreth përmbajtjes

së projektligjit, por edhe cilat projektligje kanë shans realisht për t'u bërë ligje. Disa legjislativë të vendeve të ndryshme, në shqyrtimin e projektligjeve ndjekin modelin francez, ku është themeluar Instituti i Reporterit "Rapporteur". Kështu, meqenëse çdo projektligj merret në shqyrtim nga një komision i veçantë, ky cakton një anëtar si reporter për atë projekt. Ai merr përgjegjësinë dhe drejtimin e studimit të këtij projekti, për përgatitjen e raportit përkatës, për mbrojtjen e pozicionit që mban komisioni në debatin përpara tërë Asamblesë.

Në Dhomën Britanike të Komuneve, megjithatë, projektligjet i dërgohen komisioneve pas debatit të përgjithshëm dhe pasi janë vendosur shumë detaje nga e tërë Dhoma. Në Itali, çdo projektligj që i paraqitet njëri prej dhomave legjislative shqyrtohet nga një komision dhe më pas nga vetë dhoma, e cila e miraton atë nën për nën dhe me një votim përfundimtar.

Fuqia dhe roli i komisioneve të përhershme në procesin e përgjithshëm legjislativ ndryshon shumë ndërmjet demokracive moderne, në varësi të respektimit të parimit të ndarjes së pushteteve dhe të mbajtjes nën kontroll ose mbikëqyrje dhe ballancë të ndërsjellë të legjislativit me ekzekutivin (checks and balances). Në njërin skaj qëndrojnë komisionet (komitetet) e Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të cilat janë më të fuqishmet në botë. Ato jo vetëm pranojnë projektligje përpara debatit të përgjithshëm dhe përpara se të jenë marrë vendimet kryesore politike, por, gjithashtu, mund të marrin vetë vendime të rëndësishme politike. Woodrow Wilson, Presidenti i 28 i SHBA-së (1856-1924), i quante ato "Legjislatura (Parlamente) të vogla", dhe kjo frazë është aq adekuate sot, siç ishte kur ai e shkroi atë në vitin 1885.

Komisionet e fuqishme kanë një hapësirë të gjerë për të zgjedhur si të vendosin për një projektligj të veçantë. Ato mund ta vendosin dhe ta lënë atë në raft, gjë që ndodh me shumë projektligje, ose mund t'ia raportojnë menjëherë në formën origjinale dhomës përkatëse, me rekomandimin "që ai (projektligji) të kalojë". Ato mund të vendosin, gjithashtu, ta ripunojnë projektligjin përpara se të bëjnë ndonjë rekomandim. Në këtë rast mund të



mbahen seanca dëgjimi (hearings), në të cilat ftohen për të dëshmuar përfaqësues të grupeve të ndryshme të interesuara, të lobeve dhe/ose të organizmave joqeveritare. Pas përfundimit të seancave të dëgjimit, komisionet mund të kalojnë në një seancë më të kualifikuar dhe të ridraftojnë projektligjin në masën që shihet e përshtatshme, deri në fshirjen e gjithçkaje, përveç titullit, duke e zëvendësuar kështu me një projektligj krejt të ri. Komisionet e përhershme nuk janë të kufizuar për të vepruar vetëm mbi projektligjet që u dërgohen. Ato mund të vendosin të hartojnë vetë dhe të caktojnë anëtarë për të paraqitur projektligjet e tyre të reja. Ato mund të vendosin të verifikojnë e hetojnë shkeljet e mundshme të ekzekutivit në administratë ose për këtë arsye, në shkolla, sindikata etj.

Në skajin tjetër qëndrojnë komisionet (komitetet) e Dhomës Britanike të Komuneve, të cilat nuk marrin ndonjë projektligj deri pas leximit të tij të dytë, kur tashmë janë marrë vendimet e politikës bazë. Ato janë të autorizuar të bëjnë ndryshime dhe amendamente vetëm në detaje të parëndësishme; nuk janë të specializuara në çështje të fushave të veçanta, kështu që ato nuk zhvillojnë ekspertizë të posaçme në ndonjë fushë. Anëtarët e tyre i nënshtrohen një disipline të fortë partiake, si brenda, ashtu edhe jashtë komisionit (komitetit). Për rrjedhojë, këto të fundit luajnë një rol relativisht të parëndësishëm në procesin ligjvënës britanik. Pushteti i komisioneve (komiteteve) ligjvënëse në demokracitë e tjera qëndron midis këtyre skajeve. Nga njëra anë, raportet e komisionit shërbejnë zakonisht si bazë për debat dhe veprim për të tërë legjislativin (dhe një komision ka pushtet të konsiderueshëm për të ridraftuar dhe amenduar projektligjet që i dërgohen). Nga ana tjetër, në shumicën e demokracive parlamentare, kontrolli i axhendës ligjvënëse nga qeveria dhe kontrolli i partive politike të votave të anëtarëve të tyre është kaq i fortë, sa që komisionet zor se mund të bëjnë diçka kundër dëshirës së qeverisë.

Në Shqipëri, ashtu si në Angli, komisionet zakonisht nuk bëjnë korrigjime thelbësore mbi projektligjin e paraqitur nga qeveria, ose thjesht informojnë Kuvendin në seancë plenare lidhur me mendimin ose opinionin e tyre.

## SHËRBIMI I INFORMACIONIT PËR ANËTARËT E PARLAMENTIT


Mbledhjet e komisioneve parlamentare dhe seancat plenare janë pamja spektakolare, në qoftë se do ta quanim kështu, e legjislativit të çdo vendi. Kurse pamja e padukshme e tij janë studiot, ku përgatitet materiali me informacionin e nevojshëm në shërbim të tyre. Çdo projektligj që i paraqitet për miratim legjislativit, përpara se t'i kalojë për shqyrtim dhe diskutim komisioneve të përhershme dhe seancës plenare, veç relacionit shoqërues të nismëtarit të tij, duhet të plotësohet me një material, i cili analizon dhe verifikon pajtueshmërinë e projektligjit me kushtetutën, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi dhe ligjet e tjera në fuqi dhe që përmban edhe mendimin akademik të dalë nga studimi i tij. E gjithë kjo punë kryhet prej specialistëve të caktuar, kryesisht konstitucionalistë ose juristë me përvojë, të cilët edhe mund të mos bëjnë pjesë në stafin e Kuvendit, por angazhohen në këtë punë rast pas rasti. Ky shërbim tepër i nevojshëm për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së Kuvendit ende nuk është bërë rregull pune, siç është në shumë legjislativë të vendeve të tjera demokratikë.

Gjithashtu, mungesa e një zyre të veçantë për botimet në Kuvend ka bërë që të mos publikohen dokumentet zyrtare, për pasqyrimin e mbledhjeve të komisioneve dhe të seancave plenare, dhe, për rrjedhojë, deputetët që kanë munguar nuk marrin informacionin e nevojshëm për parapërgatitjen e tyre, si dhe nuk arrihet niveli i duhur i transparencës.

Gjithashtu, moskompletimi i zyrës së Clerk-ut (të këshilltarëve ligjorë sipas emërimit tonë) i heq mundësinë deputetëve të këshillohen në kohën e duhur për çështje të ndryshme ligjore, procedurat etj., dhe pengon rritjen e nivelit dhe të efikasitetit të veprimtarisë së Kuvendit.

## Procedurat amenduese gjatë shqyrtimit në Kuvend

*Filip Lako*



Vendosja e një sistemi të ri politiko-ekonomik në Shqipëri pas vitit 1990, solli si një nevojë të domosdoshme ndryshimin dhe miratimin e një kuadri ligjor mbështetës. Dihet tashmë ndryshimet me ritme të shpejta të legjislacionit shqiptar, si dhe dinamika evolutive dhe me pretendime për përmirësime cilësore në tërësinë e tij.

Të gjitha kodet, ligjet e reja dhe ndryshimet në ligjet ekzistuese janë diskutuar e miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë sipas procedurave të përcaktuara. Në këtë shkrim nuk pretendojmë të bëjmë ndonjë vlerësim nëse këto procedura ligjvënese kanë qenë të plota ose jo. Gjithashtu, nuk mund të pretendojmë e as të krahasojmë nëse këto procedura kanë qenë më të mira ose më të këqia në këtë ose atë periudhë. Dihet që vendi ynë nuk ka pasur traditë të mirëfilltë të së Drejtës Parlamentare, dhe as një trajtim teoriko-shkencor të saj, që do të merrej, ndërmjet të tjerash, edhe me trajtimin e institucionit të Kuvendit, mënyrës se si organizohet, si funksionon, si merr vendime e si miraton ligje etj. Gjithësesi, kjo nuk do të thotë se organi më i lartë ligjvënës i Shqipërisë, i cili në periudha të caktuara të historisë, të afërta e të largëta, i cili qysh prej krijimit të shtetit shqiptar ka pasur emërtime të ndryshme, nuk ka punuar në bazë të disa rregullave të brendshme.

Në Statusin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, të miratuar në dhjetor 1928, parashikohet që administrimi i zyrave të Parlamentit ushtrohet sipas rregullores së tij të brendshme.

Në artikull (ose nenin) 38 të Statusit Themeltar thuhet tekstualisht: “Mbledhjet dhe diskutimet e Parlamentit mbahen botërisht e në përputhje me rregulloren e brendshme”. Kurse në artikullin 42 paragrafi i dytë thuhet: “Ligjet, që me vendim të Parlamentit quhen të ngutshme, votohen sipas rregullores së brendshme.” Në këtë rregullore, përsa i përket procedurave amendore, që është edhe qëllimi i kësaj paraqitjeje, nuk ka hollësi.

I varfër paraqitet ky aspekt në rregulloret e brendshme të Kuvendit Popullor të pasçlirimit, ku nuk gjen shpjegime të hollësishme e të qarta lidhur me procedurat amenduese.

Ndryshimet që ndodhën pas vitit 1990, për vetë ecurinë e ngjarjeve, nevoja dhe shpejtësia e ndryshimit dhe e miratimit të ligjeve nuk lejuan objektivisht që të parashikoheshin rregulla të plota e të sakta të procedurave ligjvënëse e aq më pak të atyre amenduese.

Me ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 u miratuan “Dispozitat kryesore kushtetuese”. Në këto dispozita, në nenin 18 thuhet: “Veprimtaria e Kuvendit Popullor dhe e Kryesisë së tij zhvillohen sipas rregullores së miratuar prej tij”. Por kjo ishte një rregullore e përkohshme pune, e cila u jepte një zgjidhje emergjente problemeve të fillimit të punës së Kuvendit Popullor dhe as që mund të pretendohet të rregullonte, ashtu si duhej, procedurat ligjvënëse ose procedurat në lidhje me amendamentet.

Më 2 korrik 1991, Kuvendi Popullor miratoi një pjesë të rregullores së tij, por kjo bënte fjalë vetëm për kryesinë, komisionet e përhershme e të përkohshme dhe byronë e grupit parlamentar. Kurse, më 14.5.1992, miratoi pjesën e dytë të rregullores që kishte të bënte me sesionet dhe mbledhjet e Kuvendit Popullor, grupet parlamentare dhe kontrollin parlamentar. Në po këtë datë, pra më 14.5.1992, u shfuqizua Rregullorja e përkohshme e punës së Kuvendit.

Me këto dy pjesë të Rregullores dhe me katër plotësime e ndryshime që janë bërë deri më 9.4.1998 ka punuar Kuvendi. Por vetëm në nenin 71 të Rregullores, me plotësimet që janë bërë në vitin 1998, në kreun që flet për zhvillimin e seancave plenare, gjejmë një farë rregullimi ligjor lidhur me amendamentet. Me këto plotësime parashikohet që propozimet për ndryshime, heqje ose shtesa të neneve të reja, nuk mund të paraqiten drejtpërsëdrejti në seancë plenare, në rast se ato nuk i janë dhënë më parë me shkrim komisionit përkatës për shqyrtim e diskutim.

Pasi propozimet ndiqnin këtë procedurë, ato shqyrtoheshin në seancë, duke diskutuar një deputet “pro” e një “kundër”. Kurse propozimet që kishin të bënin me ndonjë ndreqje gjuhësore dhe redaktoriale, që nuk preknin përmbajtjen e ligjit, mund të bëheshin drejtpërdrejt në seancë.

Praktika e punës së Kuvendit të viteve të fundit ka njohur raste kur amendamente që preknin deri dikur edhe përmbajtjen e neneve të veçanta, janë bërë gjatë seancave në diskutimet e neneve të veçanta, ose, siç quhet, në fazën e dytë, pas diskutimit në parim të projektligjit, pra, në atë të diskutimit nen për nen të projektligjit. Veprime të tilla kanë shkaktuar debate të zgjatura e shpesh të tensionuara, janë bërë propozime e kundërpropozime dhe ka pasur raste që edhe kanë penguar deri diku funksionimin normal të punëve në seancat plenare.

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë aktualisht punon me një Rregullore të miratuar më 9.4.1998, me disa ndryshime që janë bërë më 4.1.1999. Kjo është Rregullorja e parë që bëri një ndarje më të plotë e më të qartë dhe jep në mënyrë më të hollësishme organizimin dhe funksionimin e Kuvendit, procedurën ligjvënëse, kontrollin e Kuvendit dhe interpretimin dhe ndryshimin e Rregullores. Procedura amenduese është parashikuar në pjesën e dytë të Rregullores, pra në procedurën ligjvënëse.

Në pikën e parë të nenit 83 të Kushtetutës thuhet se projektligji votohet tri herë: në parim, nen për nen dhe në tërësi. Rregullorja në pjesën që flet për debatin në parim të projektligjit, në nenin 136, shprehet se amendamentet

nuk mund të propozohen gjatë fazës së debatit në parim të projektit. Procedura amenduese është parashikuar në fazën e votimit nen për nen të projektligjit.

Lidhur me çka është parashikuar në Rregullore, në 6 nene që flasin për procedurat amenduese kam disa mendime e sugjerime:

1. Kushtetuta përcakton se të drejtën për të propozuar ligje e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet, si dhe 20 mijë zgjedhës. Në nenin 138 të Rregullores parashikohet se çdo deputet ose Këshilli i Ministrave kanë të drejtë të bëjnë amendamente me shkrim, të motivuara, të cilat i paraqiten Kryetarit të Kuvendit përpara ose gjatë shqyrtimit të projektligjit në komisionet përkatëse. Amendamentet janë në vetvete një formë e zakonshme e ushtrimit të së drejtës së nismës ligjvënëse. Sipas Kushtetës, nismë ligjvënëse, përveç Qeverisë dhe deputetëve, kanë edhe 20 mijë zgjedhës, kurse Rregullorja nuk parashikon të drejtën e bërjes së një amendamenti nga 20 mijë zgjedhës. Mendoj se kjo bie ndesh me Kushtetutën. Ç'zgjidhje do të jepet nëse 20 mijë zgjedhës paraqesin amendamente me shkrim te Kryetari i Kuvendit, duke shfrytëzuar kështu të drejtën për të propozuar ligje? Rregullorja e sotme nuk jep zgjidhje.

2. Rregullorja në nenin 141 shprehet se gjatë debatit nen për nen mund të paraqiten amendamente të bëra me shkrim lidhur me probleme redaktoriale ose aspekte të tjera më pak të rëndësishme. Se cilat janë probleme redaktoriale është e kuptueshme, pra, janë ato të cilat qartësojnë idenë pa cenuar përmbajtjen, lidhur me anën gramatikore etj. Lind pyetja: Çfarë duhet të kuptojmë me fjalët “aspekte të tjera më pak të rëndësishme”? Kush do ta vlerësojë nëse aspekti është më pak i rëndësishëm? Kjo në Rregullore nuk qartësohet dhe mund të interpretohet në mënyrë subjektive.

3. Nga përmbajtja e nenit 143 të Rregullores del që pasi projektligjin e kanë shqyrtuar dhe diskutuar përfundimisht komisionet, kanë bërë propozime për ndryshime dhe fillon debati në seancë, në këtë fazë, pra, gjatë debatit u jepet e drejta deputetëve, grupeve parlamentare ose Këshillit

të Ministrave të bëjnë amendamente ose nënamendamente me shkrim për këto ndryshime që kanë bërë komisionet. Deri këtu gjithçka është e qartë dhe e kuptueshme. Në nenin vijues thuhet se “në qoftë se çmohet se amendamenti ose nënamendamenti sjell ndryshime të rëndësishme në projektligjin që shqyrtohet dhe kur mbështetet nga një grup parlamentar, një komision ose pesë deputetë, drejtuesi i seancës mund ta dërgojë atë për mendim në komisionet kompetente, duke pezulluar debatet.

Lindin disa pyetje që Rregullorja nuk u ka dhënë zgjidhje:

Në rast se drejtuesi i seancës nuk e dërgon atë për mendim në komisionet kompetente dhe nuk pezullon punimet, sepse është e drejta e tij, ç’do të bëhet me propozimin e amendamentit? A do të vazhdojnë debatet? Në rast se e dërgon për mendim në komisionet kompetente, për sa kohë do të pezullohen debatet? Mirë do të ishte që këto të shpreheshin qartë në Rregullore. Gjithsesi, kështu siç është ndërtuar neni 144, mendoj se interpretimi logjik të çon në atë që, kur drejtuesi i seancës nuk e dërgon propozimin për amendamente ose nënamendamente për mendim në komisionet kompetente, deri sa ai propozim mbështetet nga një grup parlamentar, një komision ose pesë deputetë, debati duhet të vazhdojë. Po qe se do të ishte kjo ideja e këtij neni, mendoj se në Rregullore kjo duhet të thuhej shprehimisht.

Në asnjë nen të Rregullores (për pjesën e procedurës ligjvënëse) nuk flitet për amendamentet e bëra me gojë. Me sa duket kjo është bërë për të mënjeluar dukuri të vëna re gjatë punimeve të Kuvendit të viteve të mëparshme, kur në disa raste amendamentet bëheshin me gojë gjatë seancave dhe ngjallnin debate e disa herë edhe acarime. Është e qartë se këto lloj amendamentesh, në shumicën e rasteve janë të ngatërruara, por gjithësesi mund të heqë një hapësirë që, në rast se drejtuesi i seancës do të kishte miratimin unanimit të Kuvendit, mund t’i lejonte ato. Në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Europës amendamentet me gojë mund të lejohen vetëm me miratimin unanimit të Asamblesë.

Mirë do të ishte që në Rregullore të thuhej shprehimisht se kur nuk lejohen amendamente ose kur ato quhen se nuk janë në rregull. Të tilla për shembull, për mendimin tim, do të ishin:

- kur ato nuk lidhen me temën në diskutim ose e tejkalojnë gamën e projektligjit;
- kur nuk përputhen ose janë në kundërshtim me projektligjin;
- kur ato lidhen me amendamente që janë kthyer një herë;
- kur ndryshojnë idenë e projektligjit për të cilin është rënë dakord në diskutimin në parim;
- kur nuk janë të plota, të qarta ose e bëjnë projektin të pakuptueshëm.

Ka disa paqartësi lidhur me afatet dhe që në Rregullore nuk kanë gjetur zgjidhjen e plotë e të saktë. Sipas nenit 45, komisionet duhet të fillojnë shqyrtimin e projektligjit jo më vonë se tri ditë para zhvillimit të seancës plenare. Pra, kjo nënkupton se Kuvendi ka miratuar programin e kalendarin e punimeve. Sipas nenit 131, raporti i komisionit që ka shqyrtuar projektligjin i dërgohet kryetarit, i cili urdhëron t'u shpërndahet e deputetëve, si rregull të paktën 2 ditë para datës së përcaktuar për shqyrtimin e këtij projektligji. Kurse neni 138 nuk e lidh propozuesin e amendamentit me asnjë afat; kur duhet të paraqesë propozimin te Kryetari i Kuvendit dhe kur ky duhet t'ia kalojë komisionit përkatës, për të mos penguar këtë të fundit të respektojë afatet e dy neneve të cituara më lart. Në këto rrethana mund të lindnin probleme lidhur me respektimin e programit të Kuvendit, në rast se komisioni, i cili ka mbaruar në afatin e duhur shqyrtimin e projektligjit, nuk do të jetë në afat me shqyrtimin e amendamenteve. Pra, do të pengojë respektimin e programit dhe të kalendarit të punimeve të Kuvendit.

Mendoj se diskutimi i problemeve të tilla është i vlefshëm. Mendimi racional e juridik duhet të gjejnë pasqyrim më të plotë e më të qartë në Rregulloren e Kuvendit, për të mënjanuar debatet e panevojshme dhe për të mos lënë shteg për keqinterpretime edhe pa dashje.



# Informacion mbi Veprimtaritë e Organizmave Ndërkombëtare

*Leon Shestani*



## HYRJE

Ajo çka ndodh në asamblëtë e ndryshme europiane dhe më gjerë, prek ndjeshëm zhvillimet në vendin tonë dhe në rajon. Në një garë informacioni, ku lajmet dhe transkriptet e takimeve lëvizin në kohë reale, shpeshherë ndeshemi me situata paradoksale, ku vendimmarrësit diskutojnë mbi tekste ose dokumenta për të cilat kanë dëgjuar vetëm komente ose lexuar nga shtypi i përditshëm vetëm ekstrakte, por nuk kanë mundësinë të lexojnë tekstet përkatëse dhe, për rrjedhim, të krijojnë një opinion tërësisht të tyre.

Natyrisht që një rubrikë e një reviste pothuaj të përmuajshme nuk e zgjidh këtë problem, sepse një javë vonesë është tepër në vendimmarrje, vecanërisht në diplomaci, por tenton që të ofrojë sadopak një referencë për dokumentet e rëndësishme që diskutohen në asamblëtë e ndryshme, sidomos për ato që lidhen drejtpërdrejt me vendin tonë ose rajonin.

**Duke filluar nga ky numër, do të ofrojmë një përmbledhje të ngjarjeve më të rëndësishme të asambleve parlamentare, si dhe referencat përkatëse në internet, ku këto dokumente mund të lexohen**

**nga të gjithë përdoruesit e internetit. Gjithnjë, sipas kërkesave mund të ofrojmë edhe textet e plota me e-mail ose disketë. Për këtë drejtohuni në: e-mail: lshestani@yahoo.com, ose tel. (04) 22 35 01.**

## KRIJOHET RRJETI PARLAMENTAR I EUROPES JUGLINDORE

Më datë 7-8 nëntor 2000 u zhvillua në Zagreb takimi i radhës për krijimin e Rrjetit Parlamentar (Parliamentary network) i Europës Juglindore.

Ky takim përfundoi me një rezolutë, që fokusohet kryesisht në rëndësinë e bashkëpunimit në fushën e arsimit ndërmjet vendeve të Europës Juglindore. Konkluzionet iu adresuan Presidentit të radhës të Këshillit të Bashkimit European, Presidentit të Parlamentit European, Komisionit European si dhe qeverive të vendeve pjesëmarrëse të këtij Rrjeti.

Lidhur me bashkëpunimin parlamentar, koordinatori i posaçëm i Paktit të Stabilitetit, Bodo Hombach, propozoi një bashkëfinancim të projekteve të këtij Rrjeti nga Parlamenti European dhe asambltetë parlamentare të Këshillit të Evropës dhe Task Forcës së OSBE-së.

Konkluzionet e takimit mund të përmbliidhen në:

- Rrjeti përbëhet nga delegacionet parlamentare të Shqipërisë, Bosnjë - Hercegovinës, Bullgarisë, Kroacisë, Republikës Federale Jugosllave, Maqedonisë, Malit të Zi, Rumanisë dhe Parlamentit European. Rrjeti kryesohet nga Doris Pack, Kryetare e delegacionit të Parlamentit European për Marrëdhëniet me Vendet e Europës Juglindore.
- Rrjeti i Parlamentarëve të Europës Juglindore përbën një komponent të rëndësishëm në përmbushjen me sukses të qëllimeve dhe zbatimit të Paktit të Stabilitetit, vecanërisht përsa i përket tryezës së parë të punës.
- Objektivi i këtij projekti 3-vjeçar është mbështetja e bashkëpunimit rajonal mes parlamenteve të Europës Juglindore, si dhe ndërmjet

parlamentarëve të rajonit dhe Parlamentit European, me synim shpejtimin e procesit të integritimit në institucionet europiane.

- Instituti Ndërkombëtar për Demokracinë, me qendër në Strasburg, do të ngarkohet me detyrën e Sekretariatit Ekzekutiv. Ngritja e një Task Force Parlamentare për Paktin e Stabilitetit nga ana e Parlamentit European do të materializohet me pjesëmarrjen në katër projekte konkrete.
- Përfshirja e parlamentarëve në procesin e mbikëqyrjes dhe këshillimit për Paktin e Stabilitetit, do të realizohet nëpërmjet Rrjetit Parlamentar të organizuar nga East-West Institute. Dy konferenca parlamentare në vit do të mbahen në rajon, ndërsa konferenca e tretë do të organizohet në formën e një seance dëgjimore (hearing) në Parlamentin European.

Përsa i përket objektit kryesor të takimit, që ishte bashkëpunimi në fushën e arsimit ndërmjet vendeve të rajonit, konferenca inauguruese konkludoi me këto rekomandime:

- Pjesëmarrësit i bënë apel Këshillit të Ministrave dhe Komisionit European për të përfshirë arsimimin në programin CARDS, në përputhje me kërkesën e Komitetit të Ministrave të Parlamentit European.
- Vendet e rajonit duhet të përpiqen të bëjnë ç'është e mundur për të rritur buxhetet e tyre kombëtare për arsimin. Në të njëjtën kohë, në kuadër të Paktit të Stabilitetit, përparësi më e madhe duhet t'i jepet projekteve në frymën e Procesit të Graz-it.
- U vërejt se ka një nevojë për një bashkëpunim më të madh rajonal në fushën e arsimit ndërmjet vendeve të Europës Juglindore. Bashkëpunimi duhet të përfshijë ministrinë, parlamentet dhe institucionet arsimore. Një kujdes i vecantë duhet t'i jepet mësimin të historisë së rajonit në tërësi.
- U vlerësua se parlamentarët duhet të luajnë një rol më të madh në procesin e reformës në fushën e arsimit, për ta bërë atë një pjesë integrale të procesit të pajtimit, zhvillimit dhe integritimit rajonal.

Takimi i ardhshëm do të mbahet në shkurt 2001. Ky takim do të përqendrohet në çështjet e trafikeve njerëzore, të të drejtave të minoriteteve (përfshirë këtu çështjet e emigracionit dhe refugjatëve), si dhe të mjedisit.

## PARLAMENTI EUROPIAN

Në periudhën tetor-nëntor, Shqipëria ka qënë dukshëm në axhendën e Parlamentit European. Parlamenti European shqyrtoi më 12 tetor 2000 një raport mbi projektplanin e veprimit për Shqipërinë dhe vendet fqinje të paraqitur nga Anna Karamanou, në emër të Komisionit të Lirive e të të Drejtave të Qytetarëve, si dhe të Drejtësisë të Punëve të Brendshme të Parlamentit European. Po kështu, më 21 nëntor përfundoi takimi i shtatë ndërparlamentar: Parlamenti European-Parlamenti Shqiptar.

### **1. Raport mbi Projektplanin e Veprimit për Shqipërinë dhe vendet fqinje**

Cilat ishin elementet kryesore dhe konteksti i këtij raporti?

Rezoluta e miratuar, pasi vlerëson në linja të përgjithshme projektplanin e veprimit, të hartuar nga Grupi i Punës i nivelit të lartë për Azilin dhe Emigracionin, si dhe duke marrë parasysh rezolutat e konkluzionet e mëparshme të Këshillit European të datës 16 tetor 2000, konkludon se:

- Shqipëria klasifikohet si vend tranzit dhe origjinë i emigrantëve, ku këta të fundit jo rrallë përfundojnë në rrjetin e prostitucionit, të shfrytëzimit të fëmijëve dhe një jetë të mjerueshme;
- në mënyrë të vecantë, politika shtrënguese që vendet europiane ndjekin me dhënien e vizave, është një faktor që kontribuon në rritjen e trafikut ilegal dhe i bën thirrje vendeve anëtare të BE-së për përmirësim të rolit dhe procedurave të dhënies së vizave nga konsullatat dhe përfaqësuesit e tyre;
- vlerëson si të cuditshëm faktin që një grup pune, i ngritur nga Këshilli,

ka hartuar planin e veprimit për Shqipërinë dhe vendet fqinje, në një kohë kur, në frymën e traktatit të Amsterdami, një plan i tillë veprimi duhej hartuar nga Komisioni (!).

Në rezolutë janë, gjithashtu, të listuara një sërë vlerësimesh të përgjithshme për Projekt-Planin e Veprimit lidhur me Azilin dhe Emigracionin. Më poshtë po listojmë disa nga vlerësimet e përgjithshme për Planin e Veprimit dhe për situatën në Shqipëri:

- Pas vlerësimeve të përgjithshme dhe objeksioneve lidhur me organin që duhej të miratonte këtë plan, shprehet keqardhje për mungesën e përgjithshme të ekuilibrit të këtij plani që, në masën dërrmuese, ka radhitur masa që lidhen me kontrollin dhe represionin dhe që nuk arrin të bëjë dallim ndërmjet azilkërkuesve dhe emigrantëve ekonomikë, si dhe personave që janë tranzit. Shprehet keqardhje, gjithashtu, për faktin që publikimi dhe plani në vetvete nuk ishin paraprirë nga asnjë lloj diskutimi, që të përfshinte qytetarët e Shqipërisë dhe të vendeve fqinje. Theksohet se, marrëveshjet e ripranimit me vende të pastabilizuara politikisht, siç është Shqipëria, nuk mund të konsiderohen të zbatueshme dhe nuk janë në përputhje me frymën e konventave ndërkombëtare.
- Rezoluta, duke njohur përpjekjet që po bëhen nga Qeveria Shqiptare, shpreh shqetësim për gjendjen e pastabilizuar në Shqipëri, në drejtim të:
  - mungesës së stabilitetit politik;
  - natyrës së dobët të sistemit partiak, të karakterizuar nga rivalitete të dhunshme;
  - funksionimit të dobët të Kushtetutës dhe mungesën e respektimit të ligjit;
  - kaosit administrativ; dhe
  - nivelit të lartë të krimeve dhe korrupsionit.

- Në këtë rezolutë i kujtohet Shqipërisë që përmirësimet në fushën ekonomike dhe sociale do të jenë të pamundura pa përmirësimin e gjendjes së sigurisë në vend, përfshirë këtu sigurinë dhe mbrojtjen e minoriteteve etnike.
- Gjithashtu, në rezolutë nënvizohet fakti që në Shqipëri po krijohen forca pozitive që meritojnë të mbështeten, forca që po ndjekin politikat që synojnë demokratizimin, zhvillimin e shoqërisë, rindërtimin e vendit dhe afrimin e tij me BE-në.
- Bëhet thirrje për forcimin e dialogut ndërmjet zyrtarëve europianë dhe autoriteteve qendrore e vendore në Shqipëri, nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë mes Këshillit të Europës, Italisë e Greqisë që janë kontribuesit kryesorë të BE-së për Shqipërinë, si dhe vendeve kryesore të BE-së që vuajnë pasojat e mungesës së stabilitetit të Shqipërisë, si emigracioni ilegal dhe krimi i organizuar.

## **2. Takimi Parlamenti Shqiptar - Parlamenti Europian**

Ngjarja tjetër që zotëroi Cështjen Shqipëria” në Parlamentin Europian ishte takimi i shtatë ndërparlamentar Parlamenti Shqiptar - Parlamenti Europian.

Sipas statusit aktual, marrëdhëniet Parlamenti Shqiptar – Parlamenti Europian janë të rregulluara në takime vjetore, që zhvillohen në mënyrë alternative, një vit në Tiranë dhe një vit në Bruksel.

Takimi përfundoi më 21 nëntor 2000. Nuk u arrit një deklaratë e përbashkët e kryetarëve të delegacioneve, por kryetarja e delegacionit të PE për marrëdhëniet me vendet e Europës Juglindore, zonja Doris Pack, duke konkluduar bëri këto vlerësime:

- Takimi u karakterizua nga një frymë sinqeriteti dhe bashkëpunimi. U vlerësuan përparimet e bëra në shumë fusha, por u tha se ka disa çështje për të cilat duhen bërë përpjekje të mëtejshme. Dokumenti i paraqitur nga delegacioni shqiptar u vlerësua shumë i mirë dhe si i tille do të ishte një referencë për PE-në.

Lidhur me situatën në Shqipëri:

- PE njeh pozicionin e OSBE-së, sipas të cilit zgjedhjet vendore në Shqipëri, *grosso modo* janë vlerësuar demokratike. Tani është koha që autoritetet vendore të marrin fondet e nevojshme për të filluar punën në mënyrë eficiente. Puna e autoriteteve vendore në drejtim të mjedisit, arsimit, shëndetësisë etj., ka nje ndikim të drejtpërdrejtë në kushtet e jetesës së popullatës.
- Lidhur me reformën në administratën publike dhe në drejtësi u tha se tashmë që janë miratuar shumë ligje e konventa të rëndësishme, është e nevojshme që të punohet për procesin e implementimit të tyre. Cështja e implementimit është e një rëndësie të veçantë. Forcimi i shtetit të së drejtës është jetik për qytetarët, sipërmarrësit dhe investitorët e huaj.
- Konsolidimi i sigurisë në vend, si dhe bashkëpunimi me vendet fqinje e të bashkësisë ndërkombëtare në luftën kundër krimit të organizuar, u vlerësuan si dy anë të së njëjtës medalje. Të gjithë ishin të një mendjeje se politikat dhe veprimtaritë ndërkufitare janë të domosdoshme për të luftuar trafikun ilegal.
- U vlerësua ndihma e duhur e dhënë nga Komisioni Europian dhe donatorët e tjerë për Shqipërinë për përballimin e problemeve të shumta dhe të komplikuar që ka aktualisht vendi yne.
- U nënvizua se Parlamenti Europian mbështet afrimin e Shqipërisë me Bashkimin Europian. Shqipëria është një komb europian dhe ka një pozitë strategjike nga pikëpamja gjeografike, dhe trashëgon një barrë të rëndë problemesh nga e kaluara.
- Duke vlerësuar rëndësinë e asistencës së BE-së, që synon të sjellë ndryshime pozitive në sektorët kyç në Shqipëri, për të ndihmuar vendin tonë në arritjen e standardeve europiane, u theksua edhe një herë rëndësia e aspektit të implementimit, i cili është në dorë të autoriteteve shqiptare.
- Në përgjithësi u vlerësua se, ka fusha ku vërehen përparime dhe fusha të tjera ku kërkohet më shumë për t'u bërë.

- Si përfundim, u rekomandua që të ngrihej një grup drejtues (steering) i nivelit të lartë, me synim përgatitjen e linjave kryesore në procesin e stabilizimit dhe asociimit të Shqipërisë me BE-në. Delegacionet parlamentare përkatëse do të ndjekin nga afër vazhdimësinë e progresin e bërë, si dhe do të formulojnë politikat përkatëse.



## TABLE OF CONTENTS

---

### Issue I, year 2000

	page
Editorial	3
Address by: Mr. Lorn W.Craner	6
Mr. Pjeter Arbnori	8
Mr. Kastriot Islami	10
<hr/>	
Opinions about legal policies:	
<hr/>	
❖ On some amendments to Penal Code:	
- Zamira Caka, Chairwoman of Parliamentary Legal Commission	12
- Spartak Ngjela, Member of Parliamentary Legal Commission	16
❖ On Transfer of Properties to Local Governing Units	
- Arben Malaj, Chairman of Socialist Party Parliamentary Group	18
- Jemin Gjana, Chairman of Democratic Party Parliamentary Group	21
<hr/>	
Information on Laws Passed by Assembly	28
<hr/>	
Parliamentary Law	
Transparence of parliamentary activity, by Sokol Berberi	36
Comparative view of role of Parliamentary Commissions, Perikli Zaharia	44
Amending procedures during Assembly deliberations, Filip Lako	50
Information about International assemblies 'activity	56
<hr/>	
Summary in English	64

# Congratulations to the Review

*By Pjeter Arbnori*

The only wealth my father left me was a library considered large for the time. A number of collections of old Albanian books, some of them written in the ancient alphabets of Shkoder; books by the Albanian Association of Printing in Albanian Letters in Constantinople; books published by “Bashkimi” Association, and others drew my attention then. I was in the primary school when I began to peruse the books of this library. Some Reviews in very thin paper, titled “The Debates of the National Council and the Debates of the National Assembly of the years 1920-1924” attracted me. I read at random, being curious to learn things. A long time afterward, someone donated me the full collection of the Parliamentary Debates, the speeches of the parliamentary members Luigj Gurakuqi, Gjergj Fishta, Mehdi Frasheri, Fan Noli, Ahmet Zog, Hil Mosi, Lef Nosi, Avni Rustemi, and others, who had stood out in the country’s political life. I searched in the contemporary media for additional information on Parliament, but found out that documents about parliamentary information were very scarce, if not non-existent. I realized later that in the absence of a free parliament, writings on parliament and parliamentarism in Albania would also be missing.

When political parties were allowed to be created in December 1990 and the first pluralistic elections held in March 1991, the road was opened for the opposition to be represented in the Assembly and for the free word to be heard without fear and without having penal consequences for it. When

the Parliamentary Rules of Procedures was discussed in April 1991, I remember to have proposed that a special article be added to it. It envisioned the publication of a bulletin of all the parliamentary debates, which was approved, but never realized in practice. In the legislatures of 1992-1996 and 1996-1997, we made the first attempts to publish a biweekly publication on the agenda of parliament, the brief meetings of the parliamentary committees, the meetings with the foreign delegations, the draft-laws put forward for discussion, and all its nominations and decisions. This was a some sort of a gazette, which we hoped to be able to elaborate further. Unfortunately, during the four subsequent years 1997-2000, the Assembly cancelled this periodical publication.

Now we have the pleasure to learn that the Albanian Center of Parliamentary Studies and Democratic Practices has taken the initiative to publish a Review on Parliamentary Law and Legal Policies. Apparently a group of lawyers and experts, working outside parliament will do what the parliament cannot do today. With their expertise, this group aims to inform the Albanian public of all the legislation passed by the Assembly and its amendments. By introducing the experience of European and world democratic institutions, our parliamentary activity and practice will also be enriched and our shortcomings and weaknesses will be pointed out to be gradually improved.

This specialized Review will help all to divide the wheat of a constructive debate from the supra-political chaff. This means that it should accommodate diverse political views on laws that should be approved, along with the information about, and encouragement of, theoretical and practical debates. I hope that the Review will help improve the fundamental weaknesses that we have never been able to implement in practice, namely, the parliamentary oversight. Without enhancing the role of parliamentary commissions and without doing away with the auxiliary committees set up only for "consumption", parliamentarism will never develop into a real institution in Albania.

Without knowing Parliamentary Law and without contributing to its implementation in real life, parliamentarism will remain only a right to speak, which is only one step higher than the abrogation of the article on agitation and propaganda. I think that from the theoretical point of view, this Review, modest as it may be in the beginning, will help, just like the entire free and serious media, to put another brick on the building of democracy, which is hard, but not impossible to build.

# Successes to the Review Successes to the Center

*By Kastriot Islami*

It is a pleasure and also an honor for me to express my congratulations on the appearance of a new Albanian Review on Parliamentary Law. It will be a tribune from where people can speak rationally and scientifically, like the representatives of the most important institution of a Parliamentary Republic, such as the Assembly, are supposed to speak. The Assembly members, the politicians, and the analysts will have a new possibility to express a new dimension of parliamentarism through this Review and the Center that publishes it. They can pit objectivism, professionalism, scientific and systematic activity and alternative solutions against subjectivism, politicization, and, not rarely, dilettantism, and personal battles, which are often waged in the highest temple of parliamentary democracy.

Parliamentary Law is first of all the right to information, the right to transparency, the right that the public wants to see embodied in the highest institution of their representation. Only when this right is well-balanced, both by the elected and the electors, only then the relations between the public and its representatives are balanced and the public considers the Assembly as its own institution and can never run into conflict with it, because continuous corrections and improvements avoid the ingredients that would generate conflicts.

Now a new window is opened for all parties. This is a window to a professional and analytic debate. This Review will enable us to develop a dimension that has been undeveloped so far. The theoretical-scientific dimension of the treatment of the elements of parliamentary democracy, related to such major issues as elections, the judicial system, the relational between the institutions, or the way the Assembly functions, will have an impact not only on the institutions, but also on the education of the public, which will be raised to a higher level. In this way, the broad public will be trained to take an active part in the process of drafting and approving the laws and become acquainted with the activity of the Assembly of Albania, but also have an objective and transparent information on Albanian legislation.

The Center and the Review will have as their mission also to precede the European integration of the Albanian institutions, in the sense of sensitizing the deputies, the politicians and the analysts about the approximation of Albanian legislation with the Constitution of Albania and, particularly, with the European legislation, and inviting them to contribute to this debate.

There is no doubt that the seriousness of this Review will guarantee its success. I would simply wish success to the Center of Parliamentary Studies and Democratic Practices, as well as its Review.



---

## EDITORIAL

### Purpose of publication

The founders of the Albanian Center of Parliamentary Studies and Democratic Practices [ACPSDP] have thought of publishing such a Review on parliamentary law from the moment of the foundation of this Center. The publication of a Review has been considered a natural and necessary instrument for a study center. Not only this, but the need to have a possibility to express ideas and hold debates in this field has been often discussed during the time when its founders used to work in the Assembly as advisors. Today it is a special pleasure for us to be able to publish the Review on Parliamentary Law and Legal Policies.

Why is this Review published and what is it going to offer its readers?

The presentation of legal practices in an unbiased and objective way will hold an important place in the contents of this Review. The political debate, which is reflected in the Albanian media among the various political forces in the country, is often personalized and as a result the public is not clear about the stands of various political forces on major issues that affect the interests of a broad category of people. The public is at the same

time the elector, and in this context, it should have a greater awareness of the stands and views of the various political forces.

The Review will devote special attention to legal information, bearing in mind that initial knowledge of information is one of the essential elements of a democratic society. The links between the citizens and their government are strong only when their concerns, that is, the concerns of the public, are reflected in the relevant legislation. This role of the public is closely linked with the concept of legitimacy. The citizens who consider their government legitimate are more likely to obey its laws. Participation of the public in the legislative process is very important for a democratic society. In this context, the need to find the ways and means to ensure the necessary information for the education of the public and the consolidation of the information on the institutions becomes vital.

Likewise, if we say that the concept of legitimacy of a government implies that the citizens have information about the institutions that represent them, we have to admit that knowledge by the public of the parliamentary activity and practices leaves to be desired. Therefore a transparent reflection of this activity would be a step forward for the participation of the public and the civic society in parliamentary procedures and one more effort toward development of democracy.

It is a fact that our country did not have a tradition in Parliamentary Law. Our recent and distant history is a clear testimony to this. Our Review aims to open a window to a theoretical-scientific treatment of Parliamentary Law, which originates in the source of legislative institutions, namely, elections, and continues with the way the institution of the Assembly is treated, the way it is organized, functions, makes decisions, exerts control over the executive, and so on. The deputy as an individual institu-



tion will be treated from the theoretical aspects of his status, such as immunity and irreconcilability, etc.

Bearing in mind the integrating process of Albania into Europe and beyond, it is important for the Albanian public to know and follow up the issues that are discussed today on an international level. Through our Review, the QSPPD will, among others, acquaint the Albanian public with the European experiences, such as the proceedings of the Parliamentary Assembly of the Council of Europe, the European Parliament, the Inter-parliamentary Union, the NATO Assembly, and others. This will serve to further improve parliamentary practices, raise problems, put forward alternative ideas for these issues and provide specialized information to help the public become better versed in the amendments to the Albanian legislation, the problems and achievements in this field.

The most important objective of the Center for Parliamentary Studies and Democratic Practices will however remain to render a contribution, no matter how modest it may be, to the development of parliamentary democracy and enhancement of the effectiveness of legislative process.

Taking this opportunity, we wish to thank in particular the International Republican Institute (IRI) and the National Endowment for Democracy (NED) for their financial support, which made possible the publication of this Review.

Sokol Berberi  
Executive Director  
Center of Parliamentary  
and Democratic Studies

# Information about the approved legislation in the Parliament

**1. Law No.8660, dated 18.9.2000 “On ratification of contracts for the purchase of shares of AMC Joint Stock Company”.** This contract, which was ratified by this law, was signed between the Ministry of Public Economy and Privatization and Cosmote/Telenor Consortium, classified first in the bid for privatization of AMC, which has as its objective the purchase of shares on the basis of Law No.8515, dated 21.7.1999 “On Privatization of Albanian Mobile Communication (AMC) Shareholder Company” and of the decision of the Council of Ministers, No. 121/2000 “On a supplement to the Decision of Council of Ministers No.581, dated 8.12.1999, ‘On the criteria of bid evaluation for the privatization of the AMC Shareholder Joint Stock Company.’” The contract stipulates that the Ministry of Public Economy and Privatization (seller) will sell Cosmote/Telenor Consortium (buyer) a total of 691,748 ordinary shares of the company, which make up 85 percent of its shareholder capital. The acceptable price for every share is \$123,744.5, while the total sum of purchase of shares is \$85,600,000.

**2. Law No.8661, dated 18.09.2000 “On supplementary social insurance for State Police workers”.** This law guarantees the State Police workers who are in service at the time of entry into force of Law No.8553, dated 25.11.1999 “On State Police” and their family members supplementary

benefits over and above those defined by Law No. 7703, dated 11.05.1993, “On Social Insurance in the Republic of Albania”. The police workers who will benefit from this law are: active police, police in reserve, suspended police, police with provisional pay, police in pension, students in police academies and recruits (assistant informers) with the exception of those cases for which the law provides otherwise. The State Police workers and the members of their families will benefit supplementary benefits over and above those stipulated by Law No.7703, dated 11.05.1993 “On Social Insurance in the Republic of Albania” in 8 cases that have been determined by Articles 6 up to 16. The supplementary revenues, determined by this law, will not be benefited by the workers who have been expelled from the State Police for abandoning their duties, or who have been sentenced to jail by the court with a final form verdict. The Law has 25 articles.

**3. Law No.8662, dated 18.09.2000 “On treatment of electricity bills as executive titles”.** This law provides for the electricity tax bill becoming executive title according to the model defined by the Ministry of Finances, in implementation of Article 36, of Law No.7928, dated 27.04.1995 “On the Value Added Tax”. The law has three articles and revokes Law No.8369, dated 09.07.1998 “On the treatment of the electricity bills, charged to the state entities (budgetary and non budgetary) and private subjects, as executive titles.”

**4. Law No.8663, dated 18.09.2000, “On registration, classification, way of use and control of navigation means with engines of tonnage under 20 NT”.** This law regulates the way of registration, classification, use and control of navigation means with registered engine with a net tonnage less than 20 NT. It aims to discipline the use and control of these means. The law has as its object the navigation means with a tonnage less than 20 NT, with a general engine power or engines higher than 30 kw/h or

40.8 H/P, classified as such by Albanian Naval Registry, or by the corresponding institutions of other states. For these navigation means, this law imposes the general obligation that they should be, at any moment, matriculated by the Harbor Master's office or by the offices under its jurisdiction, responsible for the said territory, and which are situated near lakes or rivers; b) registered in the offices of the border police responsible for the territory. The demand for registration by the owner or the co-owners of navigation means should be presented to the border police office, responsible for the territory, within five days from the day of the issuing of the navigation license. Among the violations envisioned by this law are the displacement, or use of navigation means, without the new certificate of use or, and, the registration of the navigation means in favor of a person condemned for a number of criminal offences according to the dispositions of the law. These violations constitute criminal offence and are punishable with fines from 100,000 to 150,000 leks and the confiscation of the navigation means.

**5. Law No.8664, dated 18.09.2000 "On some supplements to Law no.7874, dated 17.11.1994, 'On the status of the veteran of the Anti-fascist National Liberation War of the Albanian people' amended by Law 8526, dated 23.09.1999".** The legal amendment is made to article 3 of the fundamental law, which provides for the documents that should certify the existence of the veteran of the National Anti-fascist Liberation War of the Albanian people. By means of Law 8664, documents issued by the district state archives and the relevant state institutions, on the basis of the personal files in their possession, will be recognized as valid documents to certify the status of the veteran. The second legal amendment provides for the cases when the documents required by Article 3 of the fundamental law are missing, and the participation in the Anti-fascist National Liberation War and the status of veteran may be certified with a decision of the Central

Commission of the Status of the Veteran of the Anti-Fascist National Liberation War at the Ministry of Defense.

**6. Law No. 8665, dated 18.09.2000 “On a supplement to Law no.7748, dated 29.07.1993, on the status of the former politically persecuted and those punished by the communist system.”** This law amends article 10 of Law No.7748, dated 29.07.1993, and the process of the registration for the recognition of the right to this status will resume upon entry into force of this law. This process will continue up to 31.12.2000. The Law has two articles.

**7. Law No.8666, dated 18.09.2000 “On the approval of Normative Act no.4, with the power of law, dated 7.09.2000 ‘On some amendments to Law No.8554,’ dated 10.12.1999 ‘On the State Budget of 2000’”.** Through this Normative Act, the government aims: 1) To ensure the full utilization of all supplementary resources that are being realized with budget funds over the level of the annual program, from income that will be ensured from privatization of state property and the increase of the non tax budget revenues from public companies; 2) To reflect in the law on the state budget the use of supplementary resources for financing public expenditures, fully guaranteeing the macroeconomic stability and the main parameters set in the joint programs with the IMF, the World Bank for the preparation of the medium-term budget program, MTEF/1 and the poverty reduction program, PRGF; 3) To reflect in the Law on the State Budget the increase of the level of expenditures in conformity with the government priorities and the budget program approved by the Assembly; 4) To support with budget funds the projects launched in the context of the Kosova crisis; 5) To create new spaces for sectorial budget policies for 2001 from the reduction of debt service cost through the reduction of the internal stock debt during 2000.

**8. Law No.8667, dated 23.10.2000 “On ratification of convention on ‘Elimination of double taxation and prevention of fiscal evasion of income tax’ between the Government of the Republic of Albania and the Government of Malta”.** The ratified convention will be applied to the persons residing in one or both contracting states. The object of this convention are the income taxes applied on behalf of one of the contracting states, or its local authorities, irrespective of the way they are collected. The existing taxes for which the convention will apply in Albania are: 1 – income tax for juridical persons; 2 – taxes on the activity of small businesses; 3 – personal income tax.

**9. Law No.8668, dated 23.10.2000 “On issuing international passports to Albanian citizens”.** The Law provides for more complete and fairer rules of issuing international passports to Albanian citizens, compared to the existing law (Decree no.7393, dated 12.06.1990 “On issuing passports and granting visas,” and some amendments and supplements to it.) The new law does not contain some previous restrictions for issuing international passports to the military and the citizens who have not yet done their military service and others. Children under 16 years of age will also have a passport instead of a travel authorization. The validity of passports for this age group will be five years; while for the age groups over 16 years will be 10 years. The validity of the passports will be extended once, for one year. The law determines the documents that must be submitted to get a new passport and the cases when it is invalid, the deadline to get a new passport and the sanctions in case of loss of passport. The issuing of the new passports will be done upon expiry of the validity of the existing passport. The law has 16 articles and abrogates decree No.7393, dated 12.06.1990 “On issuing passports and granting visas,” (with the amendments made), and as well as every provision that does not conform to this law.

**10. Law No.8669, dated 26.10.2000 “on the temporary registration of population and their homes.”** This law aims, through this registration, to offer the Assembly, the government, the local authorities, the economic, scientific and cultural organizations, and the whole civil society reliable statistical data, necessary for the planning and realization of the general policies of development, the private and public analysis of decision-making, the scientific research and, in general, for improving the ability of the citizens to grasp the demographic, economic and social reality of the country. The law regulates the organization and realization of the general registration of the population and their homes in the Republic of Albania. The registration will be organized and implemented by the Institute of Statistics (INSTAT) under the supervision of the Central Commission on Registration and with the support of the registration commissions in the prefectures and the registration offices of communes and municipalities. The deadline for registration, according to the law, will be the midnight of 31 March 2001. The collection of data will be concluded within April 2001. The registration will cover all the urban and rural zones. It includes the resident population, as well as all the other objects within the territory of the Republic, which are used as residence, irrespective of whether they are solid or liquid properties.

**11. Law No.8670, dated 26.10.2000 “On ranks and military career in the Armed Forces of the Republic of Albania”.** This law defines the criteria and the authority that can decide on admission into the Armed Forces, the ranks, the promotion in rank and in career, the responsibilities stemming from the special character of one’s task and the military service, as well as the suspension of the military career in the Armed Forces. The military ranks are distinguishing titles and signs in the military hierarchy. Military hierarchy includes order of ranks and functions. The order of ranks and functions in the Armed Forces, according to the law, begins from

the lower to the highest, according to their links and dependence. In the sense of the law, the military career is the order of responsibilities that the military will be entrusted with during the time of his service in the Armed Forces, according to education, training, managing and professional abilities and the seniority of service. The law defines that in the military hierarchy, the military are officers, non commissioned officers and soldiers (marines). The military of the Armed Forces are military in permanent active service (career), or in temporary active service, in compulsory active service, and military in reserve.

**12. Law No.8671, dated 26.10.2000 “On powers and authorities of strategic command of the Armed Forces of the Republic of Albania”.**

This law regulates the juridical relations of strategic command and management of the Armed Forces and is based on the Constitution of the Republic of Albania, the existing laws and the experience of NATO and partner countries. This law became indispensable especially after the disbanding of the Defense Council as a collegiate decision-making body and the establishment instead of the Council of National Security, as an advisory body of the President of the Republic. This law provides for the powers and the high ranking commandeering and managing authorities of the Armed Forces, the duties and responsibilities of the President of the Republic as Commander in Chief of the Armed Forces and of the Council of National Security, as its advisory body. This Law has transferred some powers that belonged to the Defense Council to the Council of Ministers. The law provides also for the powers and responsibilities of the Prime Minister in the field of defense and the Armed Forces.

The law also provides for the duties and responsibilities of the Defense Minister in running the Defense Ministry and the Armed Forces as the highest authority of the military and civil personnel of these forces. He is liable to



the Assembly, the President and the Prime Minister for the implementation of the defense policy of the country. The Law also provides the responsibilities of the General staff, the Chief of General Staff, and the commanders of various forces. On the basis of the law, in the cases of wars, state of emergency, natural disasters, and drafting, the prefects also have their responsibilities and tasks. The Law has 44 articles and once it is approved, Law No.8467, dated 31.03.1999 “On the competences of the President of the Republic as Commander in Chief of the Armed Forces and the Council

Personat që janë të interesuar të  
abonohen në këtë Revistë, janë të lutur  
të kontaktojnë në adresën:  
**Rruga “Vaso Pasha”, Pall.2, shk. 1.**  
**(: 04 223501, e-mail:**  
**berberiscdp@albaniaonline.net**

---

Botuesit e kësaj Reviste mirëpresin dhe e  
vlerësojnë si ndihmë çdo vërejtje apo sugjerim për  
përmirësimin e cilësisë së Revistës. Vërejtjet dhe  
sugjerimet tuaja mund t'i dërgoni në adresën e  
sipërpërmendur.

*Ju faleminderit!*

---

*Those who are interested to register are  
pleased to contact at:*  
**Rruga “Vaso Pasha”, Pall.2, shk. 1.**  
**(: 04 223501, e-mail:**  
**berberiscdp@albaniaonline.net**

---

The editors welcome any suggestion or comment  
to improve the quality of the Review. You can send  
your comments and suggestions to the above  
mentioned address.

*Thank You!*

---

Kopertina: R&T Advertising  
Art grafik: Elvira Çiraku

---

Shtypur në shtypshkronjën “ALB Paper”

---

**Drejtor i Revistës:** Sokol BERBERI

**Kryeredaktore:** Elira ZAKA

**Bordi editorial:** Filip LAKO  
Perikli ZAHARIA  
Leon SHESTANI  
Sokol BERBERI

**Përkthyes:** Engjëllushe SHQARRI

**Redaktor:** Pandeli KOÇI

---

**Kjo revistë botohet me mbështetjen financiare të  
International Republican Institute (IRI)  
dhe National Endowment for Democracy (NED)**



